



FLET PËR "EPOKËN E RE", BEDRI HAMZA ■ FAQE 4-5



Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Bedri Hamza, ka treguar se strukturat e kësaj partie asnjëherë deri më tani nuk e kanë diskutuar çështjen e futjes në qeveri. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e

re", ai ka thënë se PDK-ja do të vazhdojë të jetë opozitë e fortë. Ai i ka kritikuar ish-qeverinë Kurti dhe qeverinë Hoti për dëmet që ia kanë sjellë vendit. Sipas tij, të dyja këto qeveri i kanë mashtruar qytetarët e

Kosovës. Gjithashtu, Hamza e ka kritikuar Projektligjin e qeverisë për Rimëkëmbjen Ekonomike, duke thënë se iniciativa e PDK-së është më e mirë dhe më përmbajtjesore ■ FAQE 4-5

VETËVENDOSJA KËRKON DORËHEQJEN E KRYEMINISTRIT HOTI

FAQE 3

Nënkryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, duke folur për njëvjetorin e zgjedhjeve parlamentare, ka thënë se Hoti do t'i ndihmonte Kosovës nëse do të jepte dorëheqje. Konjufca ka thënë se LDK-ja ka ardhur në krye të qeverisë duke shkelur vullnetin e qytetarëve. Ndërsa anëtarja e kryesisë e Vetëvendosjes, Albulena Haxhiu, ka thënë se gjatë katër muajve në qeveri kanë dëshmuar se në Kosovë është e mundur të qeveriset ndershtëm



HARADINAJ NË FAVOR TË NJË QEVERIE TË GJERË DHE STABILE

FAQE 7



OPINION

**ZOTËRI GRENELL, NUK
JEMI AS TË MARRË E AS
TË ÇMENDUR NËSE NUK
PAJTOHEMI, PËRKUNDRAZI!**

F. 11

Shkruan:
Behxhet Sh. SHALA
- BAJGORA



AKTUALE

**COVID-19 NË KOSOVË, TRE TË
VDEKUR NË 24 ORËT E FUNDIT**

F. 3

**OSMANI PËR QEVERINË HOTI:
AJO NUK E PËRFAQËSON
VULLNETIN E QYTETARËVE**

F. 3

**KËRKOHET QË NËNAT E TË
PAGJETURVE TË PËRFSHIHEN NË
BISEDIMET ME SERBINË**

F. 2

EKONOMI

**THAÇI, I KËNAQUR ME
SUKSESET E NDËRMARRËSVE
SHQIPTARË NËPËR BOTË**

F. 2

**OAK-U: RRETH 30 MIJË
PUNËTORË JANË LARGUAR NGA
PUNA GJATË PANDEMISË**

F. 8

**"PUSHO SHQIP", SËRISH BËN
BASHKË KOSOVËN DHE
SHQIPËRINË**

F. 9

KULTURË

**KOSOVËS IU
SHTUA EDHE
NJË DOKTOR I
SHKENCËS SË
HISTORISË**

F. 13



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Thaçi, i kënaqur me sukseset e ndërmarrësve shqiptarë nëpër botë

DUSSELDORF, 6 TETOR - Në Klubin e Bizneseve në Dusseldorf, presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka takuar shumë bashkëkombës, përfaqësues të bizneseve në

Gjermani. Ai ka thënë se është jashtëzakonisht krenar me punën dhe sukseset e ndërmarrësve tanë gjithandej nëpër botë. “Tash e disa dekada ata kanë dhënë gjithçka për lirinë, pavarësinë dhe shtet-

ndërtimin në Kosovë. Ne, bashkë me diasporën, mund t'i jetësojmë idealet e përbashkëta për forcimin e shtetit të Kosovës, ekonominë, bujqësinë dhe kulturën tonë, duke e transformuar dhe

modernizuar gjithë shoqërinë. Diaspora këtu është imazhi i gjallë i Kosovës në Gjermani. Krenar me arritjet e saj, të cilat janë arritje edhe të Kosovës”, ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në



Shqipëria i dërgon notë verbale Serbisë

Republika e Shqipërisë e ka thirrur ambasadorin serb në Tiranë për t'i përcjellë Serbisë një notë verbale, pas deklaratave të ministrit të Mbrojtjes së Serbisë, Aleksandër Vulin, në lidhje me shqiptarët. Kryeministri shqiptar Edi Rama ka thënë se “nuk do të tolerohet asnjë ofendim nga përfaqësuesit e qeverisë serbe”



TIRANË, 6 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë me dije se Ministria e Punëve të Jashtme e ka thirrur ambasadorin serb në Tiranë për t'i përcjellë Serbisë një notë verbale, pas deklaratave të ministrit të Mbrojtjes së Serbisë, Aleksandër Vulin. Rama ka thënë se “nuk do të tolerohet asnjë ofendim nga përfaqësuesit e qeverisë serbe”. “Ministria për Punët e Jashtme të Shqipërisë ka vazhduar më tutje me procesin, ambasadori i Serbisë është thirrur apo do të thirret, për t'i bërë me notë

verbale vënien në dijeni të shtetit serb se asnjë gojë e shthurur në Qeverinë e Serbisë nuk mund ta lëndojë Qeverinë e Shqipërisë, apo figurën e një ministri apo kryeministrit të Shqipërisë”, është shprehur Rama. Ministri serb pak ditë më parë komentoi deklaratën e kryeministrit Edi Rama në konferencën e përbashkët të zhvilluar me kryeministrin e Kosovës, Avdullah Hoti, pas mbledhjes së dy qeverive, asaj të Kosovës dhe Shqipërisë. Kryeministri shqiptar ka thënë

BE-së që të reagojë pasi një gjë e tillë është kërcënim për paqen. Përmes një deklarate të dytë, ministri serb i Mbrojtjes u shpreh se kryeministri i Shqipërisë do të mbahet mend më shumë për “çorapet e grisura” sesa për zhvillimin e ideve të ndritura dhe se Rama nuk ka “tru mjaftueshëm”. “Nëse Edi Rama do të kishte tru, nuk do të përpiqej ta bënte ‘Shqipërinë e Madhe’. Nëse do të kishte mend, nuk do të bënte fotografi me sfond nga flamuri i ‘Shqipërisë së Madhe’. Nëse kujdesej për paqen në rajon, nuk do t'i lavdëronte vrasësit e UÇK-së”, kishte thënë Vulin. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, duke iu përgjigjur këtyre deklaratave, ka thënë se pret që presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, të kërkojë ndjesë në emër të shtetit të Serbisë.

Kërkohet që nënat e të pagjeturve të përfshihen në bisedimet me Serbinë

PRISHTINË, 6 TETOR (ER) - Kryetarja e shoqatës “Thirrjet e Nënave”, Nysrete Kumnova, në një konferencë për media, ka kërkuar që të përfshihen në delegacionin e bisedimeve me Serbinë. “Kërkoj me ngulm që në delegacionin e bisedimeve të jetë njëra nga nënat që me dëshmi e fakte t'ia dokumentojmë delegacionit serb, krimet e bëra mbi shqiptarët. Heshtja nuk është përgjigje, prandaj sot jam këtu që t'ju them se nëse ju e keni harruar luftën dhe humbjet në njerëz, ne nuk mund ta harrojmë, pasi çdo ditë, për 21 vjet me radhë, na mungojnë në

sofrat tona”, ka thënë Kumnova. Ajo ka përmendur edhe deklaratën e Daçiçit, duke kërkuar që të mos mbyllën “bisedimet me Serbinë pa kthimin e trupave të personave të pagjetur”. Sipas saj, kjo çështje duhet të jetë prioritet i shtetit të Kosovës dhe jo vetëm i familjarëve të të pagjeturve. “Të mos mbyllën bisedimet me Serbinë pa kërkuar falje Serbia zyrtare për krimet e bëra gjatë luftës në Kosovë. Kriminelët dihen me emra dhe mbiemra dhe ata duhet të gjykohen dhe dënohen për veprat e tyre kriminale”, ka thënë Kumnova.



PSD-ja 'mbyll' Gjykatën Speciale

PRISHTINË, 6 TETOR (ER) - Kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Molliqaj, së bashku me aktivistë të kësaj partie kanë realizuar një aksion simbolik kundër Gjykatës Speciale. Me këtë rast, Molliqaj ka thënë se Gjykata Speciale është duke kryer arrestime dhe mbajtur njerëz në paraburgim

jashtë mandatit të vet kushtetues. “Sot, së bashku me aktivistët e PSD-së, e mbyllëm Gjykatën Speciale. Gjykata Speciale po kryen arrestime dhe po mban njerëz në paraburgim jashtë mandatit të vet kushtetues, rrjedhimisht në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. Nga një gjykatë

paralele prej sistemit të drejtësisë së Kosovës nuk mund të vijë drejtësia, por vetëm ndryshimi i të vërtetës së luftës çlirimtare të UÇK-së. Kosovës i nevojitet vendosja e drejtësisë prej institucioneve të saj, prandaj kjo gjykatë duhet të shkojë”, ka shkruar Molliqaj në llogarinë e vet në “Facebook”.

Një vit nga mbajtja e zgjedhjeve parlamentare në Kosovë

Vetëvendosja kërkon dorëheqjen e kryeministrit Hoti

Nënkryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, duke folur për njëvjetorin e zgjedhjeve parlamentare, ka thënë se Hoti do t'i ndihmonte Kosovës nëse do të jepte dorëheqje. Konjufca ka thënë se LDK-ja ka ardhur në krye të qeverisë duke shkelur vullnetin e qytetarëve. Ndërsa anëtarja e kryesisë e Vetëvendosjes, Albulena Haxhiu, ka thënë se gjatë katër muajve në qeveri kanë dëshmuar se në Kosovë është e mundur të qeveriset ndershmë



kthesën më të madhe politike në 15 vjetët e fundit. Qytetarët e saj treguan haptas se nuk duan të jetojnë në një shtet i cili i shërben vetëm një grushti njerëzish dhe i cili pasurinë publike ua lë në dorë keqbërësve. Me votën e tyre ata e thanë zëshëm dëshirën e tyre për shtet të së drejtës e për jetë të dinjitetshme”, ka thënë Osmani. Në këtë kontekst, Osmani ka thënë se qeveria e drejtuar nga Avdullah Hoti nuk përfaqëson vullnetin e qytetarëve të Kosovës. “Sot, një vit më pas, ky vullnet qytetar është përdhosur, ndërsa vota e tyre është tjetërsuar. Kosova frymon me pamjen e zymtë, si atë të para 6 tetorit, e cila e ka tjetërsuar vullnetin qytetar dhe e ka instaluar një qeveri, e cila jo vetëm që nuk e përfaqëson vullnetin e qytetarëve të vendit për ndryshim, por është e vendosur që t’u kundërvihet atyre si për t’u treguar se vota e tyre është e pavlerë, se ata mund të vendosin të bëjnë qeveri e të marrin vendime për vendin pavarësisht vullnetit qytetar. Edhe pse jam skajshmërisht e zhgënjyer me sjelljen e tillë të këtyre kastave politike, jam e lumtur që vazhdoj të qëndroj në krahun e bashkëqytetarëve të mi, me vullnetin e pathyer të tyre për ndryshim, vullnet i cili sot mund të jetë i ndrydhur, por jo i shuar”, ka deklaruar Osmani, duke shtuar se vullneti qytetar do të rikthehet fuqishëm.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 TETOR - Të martën është bërë një vit nga mbajtja e zgjedhjeve parlamentare në të cilat kishte fituar Lëvizja Vetëvendosje. Me këtë rast, nënkryetari i Vetëvendosjes, Glauk Konjufca, ka thënë se 6 tetori i 2019-s kishte sjellë revolucion demokratik në Kosovë por, sipas tij, ky vullnet qytetar çoi në opozitë partitë e atëhershme të pozitës. Në këtë kontekst, ai ka thënë se një vullnet i tillë qytetar është shkelur kur është shkarkuar qeveria Kurti dhe është votuar ajo Hoti. Konjufca ka thënë se kjo shkelje e vullnetit qytetar do të përfundonte nëse kryeministri Avdullah Hoti do të ndërmernte një veprim, atë të dorëheqjes. “Avdullah Hoti e ka një shans të shkëlqyeshëm t’i ndihmojë Kosovës, të japë dorëheqje dhe

t’ia lëshojë vendin vullnetit të lirë të qytetarëve sepse nuk mund të vjedhë dhe s’mund të ndërtosh një qeveri që s’e kanë votuar qytetarët. Populli i Kosovës përmes votës së lirë i vendosi partitë e PAN-it në pozitat 3, 4 dhe 6 dhe i zhvendosi totalisht jashtë peshës së vërtetë politike. Ndryshimet ndodhën përmes zgjedhjes së qeverisë Kurti, por menjëherë erdhën në shprehje interesat e përbashkëta të PAN-it me LDK-në dhe erdhën në krye të Kosovës duke shkelur dhe devijuar vullnetin e popullit një qeverisje në krye me Avdullah Hotin pa kurrfarë legjitimiteti”, ka thënë Konjufca në një konferencë për medie së bashku me zyrtaren e kësaj partie, Albulena Haxhiu. Ndërsa ish-ministria e Drejtësisë nga radhët e Vetëvendosjes, Albulena Haxhiu, ka thënë se një vit më parë qytetarët kanë votuar për ndryshime rrënjësore. Ajo ka

thënë se më 6 tetor të vitit 2019 qytetarët i dhanë fund keqeverisjes, ku Vetëvendosje kishte dalë partia e parë. “Sot është bërë një vjet që nga zgjedhjet e 6 tetorit. Vullneti i qytetarëve ishte i qartë. Më 6 tetor qytetarët votuan për t’i dhënë fund epokës së keqeverisjes dhe korrupsionit. E vjetra zhvatëse kishte rënë. Qytetarët votuan lëvizjen si subjekti i parë në vend, ku Albin Kurti mori vota më së shumti. Në këto zgjedhje Lëvizja doli me 29 deputetë ku të gjitha gratë deputete hynë në Kuvend”, ka thënë Haxhiu. Ajo ka theksuar se gjatë katër muajve në qeveri kanë dëshmuar se në Kosovë është e mundur të qeveriset ndershmë. “Ishte qeveria që ishte në fokus për të mirën e përbashkët”, ka thënë Haxhiu, duke shtuar se nuk do të bëjnë koalicion me

PDK-në. “Lëvizja Vetëvendosje nuk ka hequr vija të kuqe për subjektet që kemi deklaruar se kemi vija të kuqe. Këtu është PDK-ja. Ju e dini që në vazhdimësi kemi thënë se nuk bëjmë koalicion me PDK-në. Në sondazhet e fundit kemi mbështetjen e qytetarëve mbi 50 për qind”, ka thënë Haxhiu.

Osmani për qeverinë Hoti: Ajo nuk e përfaqëson vullnetin e qytetarëve

Për zgjedhjet e 6 tetorit të vitit 2019 ka folur edhe kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani. Ajo ka thënë se 6 tetori ka shënuar kthesën më të madhe politike në 15 vjetët e fundit. Ajo ka thënë se vullneti qytetar i një viti më pas është përdhosur dhe vota e tyre është tjetërsuar. “Më 6 tetor të vitit të shkuar Kosova shënoi

Ismaili: Për një vit qeveria Kurti dhe Hoti e futën Kosovën në krizë të thellë ekonomike dhe politike



Prishtinë, 6 tetor (ER) - Sekretari i Partisë Demokratike të Kosovës, Uran Ismaili, në një konferencë për media, ka thënë se “sot e jetojmë realitetin e paralajmërimit të PDK-së, ku ende qytetarët, me dy qeveritë, edhe atë Kurti, edhe këtë Hoti, nuk kanë arritur ta ndiejnë dorën e shtetit për tejkalimin e kësaj krize”. “Sot, pas një viti, populli sheh se me çfarë mashtrimi, inate dhe ekstremizmi është qeverisur Kosova me Lëvizjen

Vetëvendosje dhe Lidhjen Demokratike”, ka thënë Ismaili. Ai ka thënë se PDK-ja si opozitë ka përfaqësuar vullnetin e qytetarëve. “Opozitarizmi ynë nuk ka qenë i bazuar në mjete të dhunës dhe as në inate politike, por në bindjet tona se i shërbejmë Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj - pa asnjë dallim”, ka thënë ai, duke shtuar se PDK-ja, edhe pse në opozitë, ka qenë konstruktive. “Kemi votuar shfrytëzimin e buxhetit nga qeveria Kurti,

rishikimin e buxhetit të qeverisë Hoti, si dhe marrëveshje të ndryshme ndërkombëtare që kanë mundësuar investime mbi 300 milionë euro në shumë komuna të Kosovës. Kemi votuar jashtë inateve politike, për të mirën e të gjithë qytetarëve. Kemi ofruar modele alternative edhe për qeveritë”, ka thënë Ismaili. Ai ka thënë se qeveria Kurti dhe qeveria Hoti kanë pasur një seri dështimesh të cilat e kanë futur Kosovën në një krizë të thellë ekonomike dhe politike.

Vjosa Osmani e quan mashtrues Isa Mustafën

Prishtinë, 6 tetor (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, u është përgjigjur akuzave të kryetarit të LDK-së, Isa Mustafa, i cili ka thënë se Vjosa Osmani gjatë fushatës ka kopjuar Albin Kurtin dhe ia ka humbur LDK-së zgjedhjet.

Osmani ka thënë se gabimi më i madh i saj në jetë është që i ka besuar Isa Mustafës. Madje Osmani e ka quajtur mashtrues Isa Mustafën. “Gjithçka mund të gesh tek Isa Mustafa si tipar: mashtrimin, devijimin, ndryshimin e qëndrimeve sa

hap e mbyllë sytë, tregtinë me parime etj., por nuk mund të gesh asnjë pikë njerëzillëk. I kam besuar, siç i beson dikush prindit të vet, si në vitin 2014, po ashtu më 2019, kur më premtonte çdo ditë se nuk do ta braktisë rrugën që e nisëm bashkë dhe ata të cilët vetë

Mustafa i cilësonte ‘banda mafioze’, do t’i largojmë nga udhëheqja e shtetit. Lëre që e braktisi këtë rrugë, por tani po dëshmohej si shërbëtori më i denjë i po këtyre kastave që vetë i cilësonte ‘banda mafioze’. Madje si recivist... e tash edhe duke tentuar të



fitojë pikë te këto ‘banda mafioze’, duke më sulmuar mua”, ka thënë Osmani.



Flet për “Epokën e re”, Bedri Hamza

PDK-ja DO TË VAZHDOJË TË JETË OPOZITË E FORTË

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Bedri Hamza, ka treguar se strukturat e kësaj partie asnjëherë deri më tani nuk e kanë diskutuar çështjen e futjes në qeveri. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se PDK-ja do të vazhdojë të jetë opozitë e fortë. Ai e ka kritikuar ish-qeverinë Kurti dhe qeverinë Hoti për dëmet që ia kanë sjellë vendit. Sipas tij, të dy këto qeveri i kanë mashtruar qytetarët e Kosovës. Gjithashtu, Hamza e ka kritikuar Projektligjin e qeverisë për Rimëkëmbjen Ekonomike, duke thënë se iniciativa e PDK-së është më e mirë dhe më përmbajtjesore

vitin e kaluar kanë folur me pompozitet, duke e quajtur veten si koalicion i shpresës dhe sot shohin se nuk ishte ashtu. Realisht veprimet që janë bërë nga partnerët e koalicionit e kanë dëmtuar vendin. Pra, kanë dëmtuar interesat e vendit, kryesisht në përballje me pandeminë dhe në aspektin shëndetësor”, është shprehur ai. Hamza ka kritikuar projektin e qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike, duke thënë se iniciativa e PDK-së është më e mirë. “PDK-ja iniciativat ligjore për këtë çështje në Kuvendin e Kosovës i ka pasur nga fillimi i muajit prill, të cilat janë më përmbajtjesore se iniciativat e tjera, të cilat përmes pengesave administrative dhe burokratike janë vonuar deri tash dhe nuk janë futur në procedurë në Kuvend. Tani në disa seanca janë në rend të ditës, ku janë përfunduar diskutimet, por nuk po ka vullnet politik prej partive të tjera politike që t'i përkrahë iniciativat ligjore të cilat i

ka propozuar Partia Demokratike e Kosovës”, ka thënë Hamza.

“Epoka e re”: Z. Hamza, Kuvendi i Kosovës ende nuk po mund ta miratojë Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike. Çfarë është duke ndodhur?

Hamza: PDK-ja iniciativat ligjore për këtë çështje në Kuvendin e Kosovës i ka pasur nga fillimi i muajit prill, të cilat janë më përmbajtjesore se iniciativat e tjera e të cilat, përmes pengesave administrative dhe burokratike, janë vonuar deri tash dhe nuk janë futur në procedurë në Kuvend. Tani në disa seanca janë në rend të ditës, ku janë përfunduar diskutimet, por nuk po ka vullnet politik prej partive të tjera politike që t'i përkrahë iniciativat ligjore të cilat i ka propozuar Partia Demokratike e Kosovës. Ne jemi të hapur që mbi bazën e këtyre iniciativave, kushdo që ka propozime, nga cildo grup parlamentar, t'i pranojmë ato dhe t'i inkorporojmë në këtë ligj, në

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 6 TETOR - Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka bërë me dije se kjo parti do të vazhdojë të jetë opozitë. Ai ka deklaruar se nuk ka asgjë konkrete rreth mundësisë që kjo parti t'i bashkohet koalicionit aktual qeverisës. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Hamza ka thënë se PDK-ja është opozitë parimore e qeverisë dhe jo opozitë e shtetit të Kosovës. “Ne e kemi deklaruar

rolin tonë në opozitë, nuk kemi diçka konkrete në këtë drejtim. Pa pasur diçka konkrete, ne vazhdojmë të jemi parti opozitare dhe ta luajmë rolin që na takon. Pra, do të jemi opozitë e fortë aty ku ka nevojë që të jemi të tillë. Por, ne nuk jemi opozitë ku është interesi i vendit dhe qytetarëve të Kosovës. Pra, ne jemi opozitë, por qëndrimet tona janë parimore”, ka thënë Hamza. Ai ka treguar se deri më tani asnjëherë në strukturat partiake nuk është diskutuar çështja e futjes së PDK-së në qeveri. “Në strukturat zyrtare udhëheqëse të

PDK-së asnjëherë nuk është diskutuar kjo çështje, sepse nuk kemi pasur diçka konkrete që të bisedojmë. Pra, në kryesinë e PDK-së dhe në grupin parlamentar të PDK-së nuk është diskutuar kjo çështje”, është shprehur ai. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së ka kritikuar ish-qeverinë Kurti dhe tani qeverinë Hoti për dëmet që ia kanë sjellë vendit. Hamza ka thënë se këto qeveri nuk janë sjellë në nivelin e përgjegjësisë me sfidat me të cilat është përballur Kosova gjatë kësaj kohe. “Partitë që fituan zgjedhjet



mënyrë që të jemi në përkrahje të sektorit privat dhe të kategorive të shoqërisë të cilat kanë nevojë për përkrahje.

“Epoka e re”: A mund të harmonizohet iniciativa e PDK-së me atë të qeverisë?

Hamza: Projektligji i qeverisë për rimëkëmbje ekonomike ka ardhur shumë më vonë në Kuvend. Ai projekt nuk ka substancë dhe nuk i adreson nevojat e sektorit privat për të punësuarit në sektorin privat dhe kategoritë e tjera të shoqërisë. Pra, të dy projektligjet do të vendosen në votim në seancën e ardhshme, e cila do të mbahet të enjten. Ndërsa ne u bëjmë thirrje partive politike që ta përkrahin projektligjin dhe gjithçka që kanë propozime në mes dy leximeve ne jemi të gatshëm t’i trajtojmë.

“Epoka e re”: Cili propozim pritni të kalojë të enjten në seancë?

Hamza: Është në autoritetin e grupeve të tjera parlamentare se si do të vendosin.

“Epoka e re”: Sërish është aktualizuar mundësia e futjes së PDK-së në koalicionin qeverisës. Mund të ndodhë një gjë e tillë tani?

Hamza: Në strukturat zyrtare udhëheqëse të PDK-së asnjëherë nuk është diskutuar kjo çështje, sepse nuk kemi pasur diçka konkrete që të bisedojmë. Pra,

në kryesinë e PDK-së dhe në grupin parlamentar të PDK-së nuk është diskutuar kjo çështje.

“Epoka e re”: LDK-ja ka bërë me dije se i ka hequr vijat e kuqe për PDK-në. Çfarë nëse kjo parti jua bën ndonjë ofertë për të hyrë në koalicion?

Hamza: Ne e kemi deklaruar rolin tonë në opozitë, nuk kemi diçka konkrete në këtë drejtim. Pa pasur diçka konkrete, ne vazhdojmë të jemi parti opozitare dhe ta luajmë rolin që na takon. Pra, do të jemi opozitë e fortë aty ku ka nevojë që të jemi të tillë. Por, ne nuk jemi opozitë ku është interesi i vendit dhe qytetarëve të Kosovës. Pra, ne jemi opozitë, por qëndrimet tona janë parimore.

“Epoka e re”: Është bërë një vit qyshkur PDK-ja e ka deklaruar rolin e vet opozitar. Cili është vlerësimi juaj për dy qeveritë që e kanë qeverisur vendin gjatë kësaj kohe?

Hamza: Partitë që fituan zgjedhjet vitin e kaluar kanë folur me pompozitet, duke e quajtur veten koalicion i shpresës. Sot shohin se nuk ishte ashtu. Realisht veprimet që janë bërë nga partnerët e koalicionit e kanë dëmtuar vendin. Pra, kanë dëmtuar interesat e vendit, kryesisht në përballje me pandeminë dhe në aspektin shëndetësor. Por, mbi të gjitha, aspektin socio-ekonomik nuk e kanë trajtuar në mënyrën e duhur dhe kanë shkaktuar dëme të mëdha. Kështu që, parashikimet për normën negative të rritjes ekonomike janë goxha pesimiste dhe nuk janë të favorshme për vendin. Pra, të dyja subjektet politike që kanë udhëhequr ekzekutivin gjatë këtij viti, janë vonuar në procese. Madje, përveç vonesave, nuk i kanë marrë masat e duhura të cilat do ta ndihmonin ekonominë që të mos ketë rënie të nivelit të tillë.

“Epoka e re”: Po në fushat e tjera, ku kanë ngecur këto qeveri?

Hamza: Edhe në fushat e tjera nuk kanë vepruar në mënyrën e duhur dhe në interes të vendit. Për këto çështje ne qëndrimet tona i kemi bërë publike në Kuvend dhe nëpër diskutimet e tjera publike.

“Epoka e re”: Lëvizja Vetëvendosje vazhdon ta fajësojë PDK-në për zgjatjen e jetës të kësaj qeverie, duke thënë se nuk po i jep nënshkrime për mocionin. E ka diskutuar LV-ja këtë çështje ndonjëherë me ju?

Hamza: Po të ishte kjo iniciativë serioze, LV-ja paraprakisht është dashur të ulet me PDK-në, për të diskutuar me ne se çka përtej mocionit dhe si ka mundësi të sigurohen 61 votat e nevojshme për rrëzimin e qeverisë. Mirëpo kjo iniciativë nuk ka qenë serioze. Ne kemi deklaruar më herët dhe vazhdojmë të qëndrojmë në atë, se kurdo që ky mocion i plotëson kushtet për të ardhur në Kuvend, ne do të votojmë pro këtij mocioni.

Kosova ka pasur ‘përparim të kufizuar’ në reformat e lidhura me BE-në

PRISHTINË, 6 TETOR (ER) - Kosova ka pasur përparim të kufizuar në reformat e lidhura me Bashkimin Evropian, kryesisht për shkak të situatës jostabile politike, me zgjedhje të jashtëzakonshme dhe dy ndërime të qeverisë, si dhe nevojës për përballje me pandeminë. Kështu është thënë në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian që pritët të miratohet të martën pasdite në Bruksel. Në të përshkruhet situata politike prej kur Ramush Haradinaj kishte dhënë dorëheqje nga pozita e kryeministrit të Kosovës e deri te krijimi i qeverisë së Avdullah Hotit, pas rrëzimit të qeverisë së drejtuar nga Albin Kurti.

Komisioni kësaj radhe i ka dhënë vërejtje serioze Kuvendit të Kosovës për të cilin pohon se



“në periudhën që përfshin ky raport, nuk ka përmirësuar performancën e përgjithshme si një forum për dialog konstruktiv politik”. Sa i përket procesit zgjedhor, ai është vlerësuar në përgjithësi si transparent dhe i administruar mirë, megjithëse ka pasur dobësi në procesin e numërimit të votave. Edhe kësaj radhe përmendet se në mesin e komunitetit serb ka pasur frikësime të kandidatëve, të cilat nuk ishin nga Lista Serbe. Situata në veri të Kosovës vlerësohet si “sfiduese”, në veçanti sa

Haradinaj në favor të një qeverie të gjerë dhe stabile

PRISHTINË, 6 TETOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka komentuar deklaratat për përfshirjen e mundshme të PDK-së në qeverinë e drejtuar nga Avdullah Hoti. Në një prononcim për “Kosovapress”, Haradinaj ka thënë se LDK-ja e ka të drejtën të negociojë për zgjerimin e qeverisë, pasi ajo është edhe krijuese e këtij koalicioni. Në këtë kontekst, Haradinaj ka shtuar se e përkrahin një qeveri me bazë të gjerë dhe stabile e cila do t’i ndihmonte proceset nëpër të cilat është duke kaluar vendi. “LDK-ja si udhëheqëse e koalicionit, pra qeveria është krijuar nga LDK-ja, ka të drejtën të negociojë dhe diskutojë për format e ardhshme të koalicionit qeverisës. Kuptohet, Aleanca e ka vizionin e vet se si



duhet të ecë përpara. Ne e kemi bërë propozimin tonë, mirëpo nëse krijohet një qeveri e gjerë stabile ajo mund të jetë ndihmesë për procesin të cilin po kalon vendi”, është shprehur Haradinaj. Megjithatë, ai ka thënë se AAK-ja është e gatshme edhe për zgjedhje të reja. “Asnjëherë nuk duhet t’i ikim

kthimit të sovranit, pra kthimit të zgjedhjet, te votuesit, te qytetari sepse, në fund të fundit, qytetari e ka të drejtën të vendosë për më tutje. Pra, demokracia jonë është demokraci vepruese dhe deri tani zgjedhjet kanë qenë më të mirat të mundshme”, ka thënë Haradinaj.

KE-ja synon t’i investojë 20 miliardë euro në Ballkanin Perëndimor

PRISHTINË, 6 TETOR - Komisioni Evropian synon që gjatë dekadës së ardhshme të investojë deri në 20 miliardë euro në Ballkanin Perëndimor. Kështu është thënë në një plan investimi që ka parë “Radio Evropa e Lirë”. Draftdokumenti ka theksuar se prioritet do të jenë lidhjet më të mira të ekonomive të Ballkanit Perëndimor brenda rajonit, por edhe me Bashkimin Evropian. “Një gjë e tillë kërkon një angazhim të fuqishëm nga Ballkani Perëndimor për zbatimin e reformave themelore, për thellimin e integritimit ekonomik rajonal



dhe për zhvillimin e një tregu të përbashkët rajonal, bazuar në legjislacionin e BE-së, për ta bërë rajonin një zonë më tërheqëse për investime”, është thënë në këtë draftdokument. Paketa, e paralajmëruar në kulmin e krizës nga pandemia Covid-19, do të paraqitet nga

Komisioni Evropian të martën pasdite. Bashkimi Evropian ka konfirmuar se rajoni do të përfitojë shumë nga përpjekjet e shtuara, që synojnë “kapërcimin e trashëgimisë së të kaluarës jo vetëm në drejtim të normalizimit të marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës, por edhe të përfundimit me sukses të dialogut, me ndihmën e BE-së”. Paketa, po ashtu, parashikon që, përveç granteve, Bashkimi Evropian të ofrojë garanci që ndihmojnë në uljen e kostove për investime publike dhe private dhe, në këtë mënyrë, zvogëlojnë rreziqet për investitorët.

Ekonomia e Gjilanit ka humbur 788 vende të punës në kohë pandemie

GJILAN, 6 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka paraqitur para Kuvendit Komunal raportin e punës për periudhën janar-qershor të këtij viti, ku fillimisht ka nënvizuar faktin se ky gjysmëvit karakterizohet në përgjithësi nga pandemia Covid-19, ku sfidë kryesore ka qenë ruajtja e shëndetit publik dhe e ekonomisë. “Fatkeqësisht, ekonomia e Gjilanit ka humbur 788 vende të punës në kohë pandemie, prandaj aktivizimi i pakos financiare është urgjent”, ka thënë Haziri. Sipas hulumtimit të zhvilluar nga komuna dhe AZHR Lindje, Gjilani ka një rënie prej 23-përqindësh të numrit të gjithëmbarshtëm të

punëtorëve të kompanitë e anketuara, kryesisht bizneset e mëdha dhe të mesme. E njëjta situatë është deklaruar edhe nga bizneset e vogla. 46 për qind e bizneseve kanë deklaruar rënie të nivelit të shitjes prej 90-100-përqindësh dhe vetëm 1 për qind e bizneseve të anketuara kanë deklaruar se niveli i shitjes ka qenë i njëjtë. Sipas hulumtimit, del se pandemia rrezikon më së shumti bizneset e vogla. Vetëm 8 për qind e bizneseve mendojnë se mund ta përballojnë situatën e pandemisë. 84 për qind e bizneseve kanë deklaruar se nuk mund ta përballojnë situatën me pandemi dhe periudha maksimale që



biznesi mund të operojë me rezultat pozitiv ose pa humbje është tre deri në gjashtë muaj,

ndërsa 16 për qind mund të operojnë prej 3 deri 12 muaj. Shpresëdhënës është fakti se

vetëm 50 për qind e bizneseve nuk do t'i pushojnë punëtorët nga puna.

Vërshimet e fundit, Ahmeti: Kryetarët e komunave t'i aktivizojnë shtabet e krizave

PEJË, 6 TETOR (ER) - Tahir Ahmeti, njohës i çështjeve të emergjencave, njëherësh drejtor ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC), ka reaguar në lidhje me vërshimet e fundit në disa komuna të Kosovës. “Pas vërshimeve të fundit në disa zona të Kosovës (gjendja ishte më e rëndë në Komunën e Pejës dhe të Deçanit), Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka paralajmëruar për vërshime të mundshme në rajonin e Prizrenit”, ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në “Facebook”. Ai ka shkruar se kryetarët e komunave në bashkëpunim me agjencinë për menaxhimin e emergjencave (AME) duhet t'i vënë në dispozicion të gjitha resurset. “T'i aktivizojnë shtabet e



krizave në mënyrë që t'i dilet në ndihmë popullatës së prekur dhe të rrezikuar nga këto vërshime të shpejta”, ka

shkruar drejtori ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC), Tahir Ahmeti.

Shtrihet rrjeti i kanalizimit fekal në disa lagje të Katunishtës në Podujevë

PODUJEVË, 6 TETOR (ER) - Nënkrjetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Faik Muçiqi, kanë përcjell nga afër dinamikën e punimeve për shtrirjen e rrjetit të kanalizimit në fshatin

Katunishtë. Projekti i ndërtimit të rrjetit të kanalizimit fekal në këtë fshat përfshin lagjet “Kastrati”, “Bryma”, “Idrizi” dhe do të vazhdojë në lagjen “Kulla”.

Deri më tani janë shtrirë rreth 3.2 kilometra rrjet i kanalizimit në këto lagje.



Shkolla e vjetër e fshatit Krivenik në Han të Elezit do të destinohet ‘Shkollë muze’




HANI I ELEZIT, 6 TETOR (ER) - Listës së objekteve që do të mbeten në pasurinë e trashëgimisë kulturore dhe historike në Komunën e Hanit të Elezit do t'i shtohet edhe objekti i shkollës së vjetër të fshatit Krivenik. “Duke qenë ndër shkollat më të vjetra të Komunës së Hanit të Elezit, ky objekt shkollor do ta mbajë të shënuar veprën e dëshmorit Ilaz Thaçit, ushtar i UÇK-së, i cili është vlarë gjatë granatimit të fshatit Krivenik nga ana e ushtrisë maqedonase gjatë konfliktit me Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare më 29

mars të vitit 2001, duke u përpjekur që t'i shpëtojë fëmijët e shkollës të fshatit Krivenik”, është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Hanit të Elezit. Në këtë ngjarje tragjike humbën jetën edhe bashkëfshatarët e tij Baki Krasniqi dhe Arif Thaçi, si dhe gazetari Karem Lewton. Objekti i rinovuar ka mbajtur arkitekturën autentike dhe do të destinohet si objekt muze. Ky projekt është realizuar në kuadër të planifikimeve të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.

Raporti 24-orësh i IKShPK-së: 122 të shëruar, tre të vdekur dhe 34 raste të reja me Covid

Covid-19 në Kosovë, tre të vdekur në 24 orët e fundit

Gjatë 24 orëve të fundit kanë ndërruar jetë tre persona si pasojë e infektimit me Covid, duke e çuar numrin e përgjithshëm të vdekjeve në 635. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 122 persona dhe janë paraqitur 34 raste të reja. “Numri total i rasteve pozitive është 15 889 raste nga 71 356 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 635 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 122 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 14 051 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 203”, ka njoftuar IKShPK-ja



Infektive - QKUK, 1 rast nga spitali rajonal Gjilan dhe 1 rast nga spitali rajonal Prizren). Numri total i rasteve pozitive është 15 889 raste nga 71 356 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 635 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 122 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 14 051 raste, kurse numri i rasteve aktive është 1 203”, ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar edhe numrin e rasteve të reja me Covid-19 sipas komunave. “Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 6 raste, komuna Gjilan 5 raste, komuna Deçan 3 raste, komuna Mitrovicë

3 raste, komuna Pejë 3 raste, komuna Gjakovë 2 raste, komuna Istog 2 raste, komuna Podujevë 2 raste, komuna Suharekë 2 raste, komuna Vushtri 2 raste dhe me nga një rast komunat Drenas, Prizren, Rahovec dhe Skenderaj. Mbulojini gojën dhe hundën me maskë! Mbani higjienën! Respektoni distancën!”, ka njoftuar IKShPK-ja.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 TETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit kanë ndërruar jetë tre persona si pasojë e infeksionit me Covid. Po ashtu, ky institut ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 122 persona dhe janë paraqitur 34 raste të reja me

Covid-19. “Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 483 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 34 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar tre raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv (1 rast nga Klinika

Maqedonia e Veriut hap kufijtë për qytetarët e Kosovës

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije Qeveria e Maqedonisë së Veriut ka miratuar propozimin e Komisionit për Sëmundjet Infektive për hapjen e kufijve për Kosovën pa teste PCR. Zemaj ka thënë se situata momentale epidemiologjike në Kosovë nuk përbën rrezik për lëvizje. “Qeveria e Maqedonisë Veriore ka miratuar propozimin e komisionit për Sëmundjet Infektive të Maqedonisë së Veriut, për hapjen e kufijve për Kosovën pa teste PCR. Këtë ma konfirmoj zëvendësministri i Shëndetësisë, Ilir Hasani, në një bisedë telefonike. Situata momentale epidemiologjike në vendin tonë nuk përbën rrezik dhe përshëndes vendimin e sotëm për hapjen e kufijve pa test PCR. Testet PCR mund të kthehen nëse vërejmë se ka rritje të rasteve të infeksionit. Ndërsa gjatë 24 orëve të fundit në vendin tonë, 122 qytetarë e kanë fituar betejën me virusin Covid 19, ndërsa pozitivë kanë rezultuar 34. Bashkë për një rajon të shëndetshëm”, ka njoftuar Zemaj.

Haradinaj-Stublla: Situata në Luginë është alarmante, duhet ta ngrehim zërin



PRISHTINË, 6 TETOR (ER) - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës (MPJD), Meliza Haradinaj Stublla, ka thënë se situata në Luginën e Preshevës është alarmante dhe se duhet ngrehur zërin në instanca më të larta për gjendjen e shqiptarëve atje. Ajo këto komente i ka bërë të martën pas takimit me kryetarin e Komunës së Preshevës, Shqiprim Arifi. “Situata në Luginë është alarmante, e ne duhet të ngrehim zërin në instanca më të larta, që po iu bëhet shqiptarëve në atë pjesë”, ka thënë ministrja Haradinaj-Stublla. Më tutje, Haradinaj-Stublla ka thënë se gjatë takimit me Arifin kanë diskutuar për disa projekte

infrastrukturore dhe çështje të tjera me interes. “Kemi nisur një platformë të takimeve jo vetëm me fotografi, por me takime konkrete. Në këto takime kemi diskutuar për projekte infrastrukturore të komunave të Luginës së Preshevës”, ka thënë Haradinaj-Stublla, duke shtuar se e kanë mbajtur premtimin që e kam dhënë për pesë studentët e shkencave politike të Luginës së Preshevës. Ndërsa kryetari i Komunës së Preshevës, Shqiprim Arifi, ka thënë se takimet me ministrin Haradinaj-Stublla janë duke rezultuar të suksesshme. “Ka qenë një takim substancial dhe shumë miqësor. Këto takime nuk i kemi pasur vetëm si fotografi, por sot është parë një

sukses nga MPJD-ja, sepse sot kanë filluar praktikën pesë studentë të Luginës, dhe jo vetëm këtë, por kjo ministri po bën shumë punë sa iu përket shqiptarëve të Luginës së Preshevës”, ka thënë kryetari Arifi.

Po ashtu, Arifi ka falënderuar ministrin Haradinaj-Stublla, për raportin e krijuar me kryediplomatit e Shqipërisë, Gent Cakaj. “E falënderoj edhe ministrin për takimin që ka pasur me Gent Cakajn, për Fondin që është krijuar, e kjo është diçka e mirë për shqiptarët. Ne, po ashtu, e kemi edhe një draft se si do të duhej të jetë ky fond, por gjatë ditëve të ardhshme do ta publikojmë”, ka thënë ai.

Hoti: Qeveria dyfishon subvencionet për vreshtarët dhe verëtarët

Prishtinë, 6 tetor - Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, bashkë me ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, si dhe kryetarin e Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, kanë mbajtur një takim

me shoqatat e vreshtarëve dhe verëtarëve të Komunës së Rahovecit. Ky takim është realizuar me kërkesë të kryeministrit Hoti, i cili para të pranishmëve ka shpaluar prioritetet e qeverisë për përballimin e situatës së shkaktuar nga pandemia Covid-19 dhe ka

konfirmuar mbështetjen institucionale, duke theksuar faktin për dyfishimin e subvencioneve në sektorin e bujqësisë, të cilat ndikojnë në tejkalimin e sfidave dhe zhvillimin e këtij sektori. “Me rishikim të buxhetit kemi krijuar një fond që është rreth 5

për qind e bruto produktit vendor dhe nga kjo shumë ne kemi lëshuar mjete për ekonominë nëpër sektorë të ndryshëm, si dhe nga një vendim i marrë, i cili prek edhe shoqatën tuaj, janë



edhe 60 milionë euro edhe për bizneset”, ka thënë Hoti.

OAK-u: Rreth 30 mijë punëtorë janë larguar nga puna gjatë pandemisë

Anëtari i Bordit i Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), Hasan Gigollaj, ka deklaruar se si pasojë e gjendjes së krijuar gjatë pandemisë, një numër i konsideruar i bizneseve janë mbyllur dhe ky numër është në rritje. “Bazuar në të dhënat në terren, del se numri i punëtorëve që janë larguar nga puna po sillet rreth 30 mijë dhe nëse vazhdohet me këtë avaz dhe nëse nuk e kemi përkrahjen e shtetit, këto shifra rrezikohet të shkojnë nga 50 mijë deri në 70 mijë qytetarë të papunë”, është shprehur Gigollaj



parasysh kërkesat tona dhe propozimet tona që kemi adresuar”, është shprehur Gigollaj.

Ai, po ashtu, ka kërkuar të subvencionohen pagat për të punësuarit për periudhën maj, qershor, korrik, gusht dhe shtator, jo më të ulëta se 220 euro në muaj. “Të subvencionohen pagat për të punësuarit për periudhën maj, qershor, korrik, gusht, shtator jo më të ulëta se 220 euro për të punësuarit në muaj. Lirimi i plotë i lëndës së parë duke respektuar normativat dhe lëndën e parë. Lënda e parë të lirohet sikurse kur blihet jashtë vendit ashtu edhe brenda territorit të Kosovës. Krijimi i pakos ku çdo produkt vendor subvencionohet në dalje me 10 për qind ulje. Të subvencionohet eksporti me 10 për qind të shumës së eksportuar, ulja e TVSh-së në 5 për qind për ushqim, turizëm dhe hoteleri, krijimi i fondit për investime dhe zhvillim përmes

së cilës mund të realizohen të gjitha këto subvencionime për përkrahjen e bizneseve”, ka shpjeguar ai.

Më tutje, ai ka kërkuar lirimin nga pagesa e tatimit në fitim për kompanitë nga industria që kanë pësuar dëme nga pandemia për periudhën e muajve prill-shtator 2020. “Sa i përket kredive, OAK kërkon që të lejohen kredi për bizneset me grejsë periudhë deri në dy vjet dhe me afat pagese deri në 10 vjet, me garanci 80 deri në 100 për qind të shtetit. Kredia t’iu mundësohet bizneseve edhe për veprime operationale që përfshinë paga apo shpenzime të tjera. Kreditë të jenë pa interes me grant prej 30-përqindësh për ndërmarrjet mikro dhe të vogla përmes fondit për garanci kreditore. Ulja e normës bazë të interesit të Bankës Qendrore në 1.7 për qind në mënyrë që bankat komerciale të kenë mundësi t’i ulin kamatat e tyre. Bazuar në analizën e OAK se si kanë vepruar bankat në vendet e

rajonit gjatë kësaj periudhe, del se kanë ulur interesin deri në 0.25 për qind përderisa BQK-ja është sjellë si mos të ketë fare pandemi në vend. Po ashtu, mosharmonizimi i ligjeve në vend në mes vete paraqet një sfidë tjetër të të bërit biznes. Dhe ne si OAK kemi bërë kërkesë për këto ndryshime”, ka deklaruar ai. Ndërsa zyrtarja ligjore e OAK-ut, Diellza Zeqiri, ka folur rreth harmonizimit dhe ndryshimit të ligjeve për arsye të bizneseve dhe investitorëve të huaj. “Oda e Afarizmit e Kosovës ka disa propozime lidhur me harmonizimin e ligjeve dhe plotësim-ndryshimin e tyre për arsye se bizneseve dhe investitorëve të huaj po iu vështirësohet bërja e biznesit në Kosovë. Si propozime për plotësim të ndryshimit të ligjeve janë kryesisht ndryshimi i udhëzimeve administrative nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e cila afekton sidomos në sektorin e bujqësisë, blegtorisë, minierave, mineraleve dhe turizmit. Po ashtu, Ligji i Punës dhe Lehonisë, Ligji për Tregti të Brendshme, Ligji i Minierave dhe Mineraleve të ulet TVSh-ja për turizëm dhe ushqime në 5 për qind. TVSh-ja të paguhet në inkasim e jo në faturim, të krijohen oferta për biznesin, Ligji për investime strategjike si dhe ndryshimi i Ligjit për shoqëri tregtare”, ka thënë Zeqiri.

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 6 TETOR - Bizneset gjatë kohës së pandemisë, por edhe pas stabilizimit sadopak të gjendjes, janë duke u ballafaquar me një situatë të vështirë, me një numër të madh të bizneseve të falimentuara dhe humbje të vendeve të punës deri në 30 mijë. Kështu është bërë me dije të martën nga Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK) në një konferencë për media me temën “Pandemia dhe vështirësitë e të bërit biznes”.

Anëtari i bordit i OAK-ut, Hasan Gigollaj, ka deklaruar se si pasojë e gjendjes së rëndë, një numër i bizneseve janë mbyllur dhe ky numër është në rritje. “Bazuar në të dhënat në terren, del se numri i punëtorëve që janë larguar nga puna po sillet rreth

30 mijë dhe nëse vazhdohet me këtë avaz dhe nëse nuk e kemi përkrahjen e shtetit, atëherë këto shifra rrezikohet të shkojnë nga 50 mijë deri në 70 mijë qytetarë të papunë”, ka thënë Gigollaj. Ai ka ritheksuar se disa herë kanë adresuar te qeveria, por edhe te deputetët, kërkesat për bizneset, por të njëjtat nuk janë marrë parasysh.

Gigollaj ka kërkuar që sa më parë në Kuvend të miratohet edhe Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike. “Jemi dëshmitarë që për të disatën herë nuk është duke kaluar Pakoja për Rimëkëmbje Ekonomike. Duket sikur qeveria dhe deputetët nuk janë të interesuar për të kaluar kjo pako e cila është kaq e nevojshme dhe e rëndësishme për bizneset dhe vetë qytetarët. Andaj ne si Odë e Afarizmit e Kosovës kërkojmë që të merren

ARKEP: S’kemi informata zyrtare nëse Telekom Serbia ka shprehur interes ta blejë IPKO-n

Anëtari i bordit i ARKEP-it, Shqipërim Pula, në raportimin e tij para anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Ekonomi, ka bërë me dije se, pas një takimi me përfaqësuesit e Telekomit të Sllovenisë, si përfaqësues të shitjes së IPKO-s, u është thënë se ka të interesuar disa blerës të mundshëm në proces dhe se ky numër është dyshifror, asgjë më shumë. Pavarësisht prej kësaj, Pula ka thënë se në asnjë variant Telekom i Serbisë nuk do të jetë blerës i IPKO-s

/Epoka e re/

PRISHTINË, 6 TETOR - Bordi i Autoritetit Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) ende nuk e di zyrtarisht nëse Telekom Serbia ka shprehur interes ta blejë operatorin telefonik IPKO në Kosovë. Anëtari i bordit i ARKEP-it, Shqipërim Pula, në raportimin e tij para anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Ekonomi, ka thënë se pas një takimi me përfaqësuesit e

Telekomit Slloven, si përfaqësues të shitjes së IPKO-s, është thënë se ka disa blerës të mundshëm në proces dhe është numër dyshifror, asgjë më shumë. “Emrat potencialë të blerësve nuk na i kanë treguar. Ne si autoritet ua kemi bërë të qartë se në përfundim të fazës së dytë janë të obliguar t’i tregojnë emrat e kompanive potenciale dhe pas kësaj ne do t’i njoftojmë institucionet përkatëse sepse kemi të bëjmë me sigurinë kombëtare. Pra, përfaqësuesit e Telekom



Sllovenia janë pajtuar që do t’i tregojnë emrat për t’u hetuar nga AKI dhe Agjencia për Inteligjencë Financiare se a është i pranueshëm për shtetin tonë”, është shprehur Pula. Ai nuk ka përjashtuar mundësinë që deri në nëntor ose dhjetor mund të përfundojë procesi i tretë dhe përfundimtar i privatizimit.

Ndërsa anëtarja e Komisionit për Ekonomi, deputetja Minoza Kusari-Lila, ka thënë se ARKEP-i aktualisht është

jolegjitim pasi nuk ka kuorum bordi i saj (vetëm katër anëtarë) dhe në këtë mënyrë nuk ka të drejtë ta udhëheqë këtë proces. “Çfarë autoriteti ka sot ARKEP-i të bisedojë me një përfaqësues të shitjes? Duhet të plotësohet ky bord për të qenë funksional pasi Shqipërim Pula flet në emër të ARKEP-it pa pasur legjitimitet”, ka thënë ajo.

I shqetësuar me këtë proces është shprehur deputeti Pal Lekaj, i cili ka kërkuar garanci nga ARKEP-i që asetet e IPKO-s

nuk shkojnë aty ku nuk duhet, në këtë rast te Telekom Serbia pasi, siç ka theksuar ai, rrezikohet siguria kombëtare. Në anën tjetër, anëtari tjetër i këtij komisioni, Hekuran Murati, ka kërkuar qëndrim nga drejtuesit e ARKEP-it, se në rast se do të jetë blerës i IPKO Telekom Serbia, a do të pajtoheshin me këtë blerës? Për këtë Pula është përgjigjur: “Për aq kohë sa jam unë në ARKEP në asnjë variant Telekom i Serbisë nuk do të jetë blerës i IPKO-s. Nuk e themi këtë për patriotizëm”, ka thënë Pula. Kurse Ferat Shala, anëtar i Komisionit, ka pyetur se çfarë ndodhë në rast se mbetet ARKEP-i pa bord deri në dhjetor dhe shitja e IPKO-s bëhet në këtë muaj. Edhe pse bordet pa mandat nuk mund të marrin vendime, Pula është përgjigjur se do të mbesin anëtarë në detyrë. Bordi i ARKEP-it do të mbetet pa mandat nga 15 dhjetori i këtij viti.

“Pusho shqip” sërish bën bashkë Kosovën dhe Shqipërinë

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit i Shqipërisë, Blendi Klosi dhe ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, kanë organizuar në Prishtinë ceremoninë “Pusho shqip” në shenjë falënderimi për bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet dy vendeve në fushën e turizmit. Me këtë rast, ministri Klosi ka vlerësuar lart kontributin e qytetarëve të Kosovës në zhvillimin e turizmit në Shqipëri. Klosi ka thënë se e kanë një shtëpi të përbashkët për të gjithë kosovarët që shkojnë në Shqipëri. “E kemi shtëpinë e përbashkët për miliona turistë që vizitojnë anët tona të kufirit. Atëherë kur kishim nevojë për turizëm ishte Kosova. E filluam me Durrësin në veri e në jug. Edhe ky vit është shumë i vështirë, flukset e vizitorëve ishin të pranishëm gjatë gjithë verës”, ka thënë Klosi



Kurtishaj: Të pazakonshmen e bëmë të zakonshme

Kryetari i Shoqatës së Transportit Rrugor dhe pronari i “Sharr Travel”, Ruzhdi Kurtishaj, ka kujtuar kohët e vështira nëpër të cilat ka kaluar Kosova dhe dëshirën e flaktë për të arritur në Shqipëri. Ai ka thënë se e ka pasur qëllim kryesor në jetë dhe vazhdon ta ketë hapjen dhe heqjen e kufirit me Shqipërinë, për të cilën gjë ka thënë se është punuar shumë dhe vazhdon të punohet. “Ju jeni dëshmitarë se ne lobuam për ta hapur kufirin dhe e bëmë. Me përkrahjen tuaj do të llobojmë për ta hequr krejt atë. Këtë qëllim e kam pasur dhe do ta kemi prehër në jetë. Jam i bindur se së bashku do ta arrijmë. Nga dashuria për Shqipërinë u sakrifikuam shumë edhe në rrethanat kur Jugu dhe Veriu i Shqipërisë thuajse ishin

të panjohur për njëri-tjetrin, por arritëm t'i ofrojmë e t'i bashkojmë. Dikur për të arritur nga Prishtina në Sarandë duheshin rreth 30 orë rrugë, por nga dashuria e madhe na dukeshin sikur tri orë. Sot Shqipëria është krejt tjetër. Është ajo që dua unë, por edhe kompanitë të cilat i përfaqësoj ‘Sharr Travel’ dhe ‘Blue Travel Kosova’. Zemra më bëhet mal kur shoh flotën më moderne të autobusëve në vend që disponon ‘Sharr Travel’, ku për çdo ditë bartim pushuesit e Kosovës drejt shtetit ku flitet shqip, hahet shqip e këndohet shqip”, ka deklaruar ai. Kurtishaj ka thënë se edhe pse në saje të rrethanave pandemike, së bashku me aktorët qeveritarë të Shqipërisë

kanë arritur që të pazakonshmen ta bëjnë të zakonshme. “Sivjet kemi pasur një sezon të jashtëzakonshëm, por të zakonshëm e keni bërë ju së bashku me ne. ‘Sharr Travel’ dhe ‘Blue Travel Kosova’ sivjet për qytetarët e Kosovës kanë sjellë në treg ofertat më të mira e më të lira, e një trend i tillë do ta vazhdojë edhe në ditët, në muajt e në vitet në vijim. I falënderoj nga zemra qytetarët që na besuan dhe vazhdojnë të na besojnë”, ka thënë Kurtishaj. Të pranishëm në ceremoni ishin edhe kryetarë bashkish nga Shqipëria, si dhe disa kryetarë të komunave të Kosovës. Po ashtu, në ceremoninë “Faleminderit Kosovë!” morën pjesë personalitete të shquara nga Shqipëria dhe Kosova.

fundi, kemi vlerësuar nga të dyja anët se është sektori i turizmit”, u shpreh Krasniqi. Më tutje, ai ka deklaruar se duke parë interesin e dyanshëm, fillimisht është

hapur sezoni veror turistik në Shqipëri me moton “Pusho shqip”. “Jo vetëm se kemi pushuar shqip, jemi ushqyer shqip, sepse kështu na

bashkojnë kultura dhe historia”, është shprehur Krasniqi, duke ftuar qytetarët nga Shqipëria për të pushuar në bjeshkët e Kosovës.

ATK-ja dhe Dogana nisin aksionin në disa “mobil-shop” të Prishtinës

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), në bashkëpunim me Doganën e Kosovës, kanë zhvilluar të martën një aksion në Prishtinë te disa biznese nga sektori që veprimtari kanë shitjen dhe servisimin e telefonave mobilë. Ky aksion ka pasur për qëllim parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale në këtë sektor, i cili është vlerësuar paraprakisht se ka risk të lartë të informalitetit



gjitha aktivitetet e saj për luftimin dhe parandalimin e ekonomisë joformale i ka në harmoni me Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e

Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023, si dhe bazuar në Planin Operativ të ATK-së, analizën e riskut dhe Departamentin e Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës.

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 TETOR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), në bashkëpunim me Doganën e Kosovës, njoftojnë se janë duke

zhvilluar aksion në Prishtinë te disa biznese nga sektori që veprimtari kanë shitjen dhe servisimin e telefonave mobilë. Sipas njoftimit të ATK-së, qëllimi i këtij aksioni ka qenë parandalimi dhe luftimi i ekonomisë joformale në këtë sektor, i cili është

është vlerësuar paraprakisht se ka risk të lartë të informalitetit. “Ky aksion është duke u zhvilluar edhe në këto çaste, ku deri më tani janë duke kontrolluar disa subjekte, mirëpo ATK dhe

Zotëri Grenell, nuk jemi as të marrë e as të çmendur nëse nuk pajtohemi, përkundrazi!



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Mbytja e demokracisë përmes arrogancës: Kosova është vend sui generis në çdo pikëpamje. Këtë kartë e përdorim kur duam të arsyetohemi për një vendim që do të merrej në një vend normal e që nuk e marrim, prandaj thirrëmi në sui generis. Këtë e përdorim si arsytim për llaskucëri dhe nënshtrim paraprak ndaj atyre që e bënë Kosovën rast sui generis sikur edhe për ta arsyetuar mungesën e kompetencës, profesionalizmit, korrupsionin dhe shpërdorimin e besimit, herë të dhënë e më shumë të uzurpuar për të ushtruar pushtet dhe për të punuar për të mirën e qytetarëve dhe shtetit. Të tillët, vetëm formën apo mbështjellësin e kanë të ruajtur, kurse përmbajtjen e kanë krejtësisht boshe, false dhe të qullët. Këtë më së miri e kanë vërejtur ndërkombëtarët andaj gjithmonë i kanë përdorur për realizim të qëllimeve dhe projekteve politike qofshin ato edhe në dëm të Kosovës e që kryesisht kanë qenë të tilla, ndryshe nuk do të ndodhte që Kosova të penalizohej 22 vjet pas përfundimit të luftës me formimin e një gjykate kriminale, raciste dhe pse jo edhe fashiste e që për qëllim, jo ndarjen e drejtësisë për të gjitha viktimat që do të duhej edhe të ishte, por legalizimin e ndërhyrjes së Serbisë në punë ekskluzivisht të brendshme të Kosovës dhe këmbëngulja e ndërkombëtarëve që Serbinë ta trajtojë si viktimë. Ne që kemi qenë këtu, të udhëhequr nga ndonjë interes, kryesisht të vogël sepse ato të mëdhatë kanë qenë e drejtë e pakundërshtueshme e bartësve të pushtetit e që disa kanë qenë edhe idealistë, nuk kemi dashur ta pranojmë këtë realitet. Qoftë edhe të pushtetit fiktiv. Thonë se nëse doni ta provoni karakterin apo mungesën e karakterit të një udhëheqësi apo personaliteti publik krijoni mundësi që: të ketë para, të ketë femra dhe të ketë pushtet mbi të tjerët. Perandoria romake si dhe perandoritë e mëdha janë shkatërruar pikërisht për shkak të korrupsionit apo grykësisë për pasuri të ftuar pandershmërisht, jetës së shfrenuar morale dhe shpërdorimit të pushtetit ndaj vartësve të tyre. Ndërkombëtarët, që janë sjellë si kolonizatorë në Kosovë, saktësisht e kanë të qartë këtë dhe i përdorin si mashë e pastaj, në fund të fundit, i lënë në

baltë sikur që, të pamësuar se dikush edhe mund të ketë mendim të kundërt me ta, pa asnjë skrupull moral e eliminojnë. Rast tipik për këtë e keni Bacën Adem Demaçi të cilit nuk i lanë asnjë hapësirë për ndonjë post të lartë vendimmarrës politik. Po në të njëjtën mënyrë po sillen duke e formuar dhe instrumentalizuar një gjykatë puro raciste dhe politike e quajtur Gjykata Speciale që nuk merret me asnjë rast të krimeve që i ka bërë Serbia në Kosovë por, me dosje të Serbisë po organizon gjah ndaj shtrigave apo ndaj UÇK-së dhe bartësve më të lartë të hierarkisë politike dhe ushtarake të kësaj Ushtrie Çlirimtare të Kosovës. Pastaj, për të qenë më i qartë për ndërhyrje flagrante të ndërkombëtarëve në ndërtimin e institucioneve të Kosovës sipas nevojave të tyre, merreni me mend, një bandit i veshur me petkun dhe postin e ambasadorit të shtetit më të fuqishëm në botë, i shoqëruar me një prostitutë politike e quajtur Pushikar, nuk la gjë pa përdorur (përfundimtar bombën atomike) derisa e zgjodhi Behgjet Pacollin, kryetar të Kosovës, së bashku me pjesën dërrmuese të ish-shokëve dhe bashkëpunëtorëve të Bacës Adem, që u bënë bisht i ambasadorit mashtrues dhe bandit. Deri atëherë edhe unë, mbështetur në injorancën time, pata besuar se disa gjëra në Kosovë, megjithatë, nuk mund të ndodhin. Rasti Pacolli më bindi se në Kosovë nuk ka gjë që nuk mund të ndodhë, prandaj të gjitha që janë bërë më vonë janë lulë krahësuar me veprimin e Dellit dhe Pushikarit. E tash po merremi pse Zafir Berisha qenka emëruar koordinator kombëtar për luftim të krimeve kibernetike. Së pari Zafa kombëtarisht ka qenë gjithnjë në rregull, deputet në shumë mandate dhe kundërshtar i papërmirësueshëm i Serbisë të cilën tani do ta luftojë si sajber kamikaz. Pritni rezultatin përfundimtar kur Zafa do të shkaktojë tollovi në të gjitha sistemet elektronike të Serbisë dhe paralizë të çdo funksionimi. Nëse Grenelli nuk do të kërkojë “miqësisht” të mos e bëjë këtë. Më rrethanat aktuale, vox Grenelli është vox dei, fjala e Grenellit është fjala e Zotit për të gjithë ata që duan të mbijetojnë në pushtet. Realisht, si lexues pasionues i të gjitha postimeve të Zafës dhe duke e ditur cilësinë e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, vendi më i përshtatshëm për Zafën do të ishte të bëhet kryetar i kësaj Akademie apo, në rastin më të keq, anëtar i Akademisë së Arteve dhe Shkencës. Tjetër vend që është adapt me të si njeri i Popullit e që tërë jetën ia ka kushtuar popullit është të zgjidhet Avokat i Popullit në mandatin tjetër. Kjo e

koordinatorit kundër krimeve kibernetike në masë të madhe e zbeh personalitetin e Zafirrit dhe është në shpërputhje të madhe me kapacitetin profesional dhe intelektual. Por, nëse Begja ishte bërë president i Dellit dhe Pushikarit, pse Zafa të mos bëhet një koordinator, qoftë edhe sajberist joprofesional! **Pse duhet të pajtohemi me çdo gjë:** Në kohën kur Albin Kurti ishte kryeministër i Kosovës, e takuan të gjithë ndërkombëtarët dhe shprehën gatishmëri për bashkëpunim sidomos në pikën më interesante dhe mbase edhe të vetme për ta, bisedimet për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë, pa kushte për Serbinë por me plotë kushte për Kosovën, me ide kreative si dhe kompromis të dhimbshëm për Kosovën. Albin Kurti i ka pasur të qarta të gjitha këto prandaj insistonte që ai, e jo presidenti Thaçi të jetë në krye të Ekipit Negociator që, në një masë edhe u pranua. U takua edhe me Grenellin në Zyrat e LV-së, krijuan në raport i cili pastaj eskaloj në një armiqësi në çastin kur u votua mocioni i mosbesimit ndaj Qeverisë Kurti. U përdorën fjalë që nuk përdoren midis partnerëve dhe ndaj Grenellit kishte akuza eksplicite mbase edhe të sakta se qëndron prapa rrëzimit të Albin Kurtit. Përkundër të gjithave, Albin Kurti është dashur të merr përgjegjësi, të shkojë në Uashington, t'i lërë thikat në mishtore dhe, nëse në atë, ta quaj marrëveshje ka diçka që e dëmton Kosovën, thjesht ka mundur të kërkojë që kjo të diskutohet në Kuvend e jo që të mos marrë përgjegjësi. Marrëveshja e nënshkruar e që aspak nuk ka elemente të marrëveshjes, në Parkun me Trëndafilat e që u nënshkruar nga karajfilat e pranishëm, është projekt i bërë sipas nevojave të Presidentit Trump për zgjedhjet e nëntorit në Amerikë. Aty ka gjëra që nuk kanë asnjë lidhje me ekonominë apo normalizim të marrëdhënieve ekonomike me Serbinë. Janë gjëra puro politike. Serbia definitivisht është përfutjesja më e madhe, nga një shtet me të kaluar kriminale dhe gjenocidale, me një të tashme të një autokracie despotike, u bë e përkëdhelura e Amerikës dhe Donald Trumpit. Kosova, në aspektin politik ka shënuar një prapaktim kurse eventualisht mund të përfitojë në planin ekonomik nëse ia gjuajnë një kokërr misri, si pulës porre. Përralla janë të Trumpit dhe Grenellit se do të investohen 13 miliardë dollarë dhe, as në imagjinatën më të skajshme nuk e besoj këtë. Njohja nga Izraeli u quajti si historike dhe nuk e di pse do të ishte historike kur këtë para neve (si vend me shumicë myslimane – Trumpi e tha) e kanë bërë Emiratet e Bashkuara Arabe dhe pastaj edhe Bahreini. Do të ishte historike po të na


njihte Kina apo Rusia, si superfuqi ekonomike dhe politike e jo Izraeli që ka probleme të pazgjidhura me shumë vende arabe. Është joserioze dhe politikisht injorancë e skajshme të pranoni se ambasadën e Kosovës do ta vendosni në Jerusalem kur këtë, deri më tani e kanë bërë vetëm dy shtete, Amerika dhe Guatemala dhe asnjë nga shtetet evropiane. Edhe rezoluta e Kombeve të Bashkuara qartë e dënon çdo vendosje apo zhvendosje të ambasadave nga Tel Avivi në Jerusalem. Ne duhet të kemi raporte normale me Izraelin sikur edhe me vendet tjera që na kanë njohur dhe do të na njohin dhe nuk shoh asgjë historike në këtë njohje. Edhe pa na njohur Izraeli, disa mashtrues ordinerë që janë pjesë e komunitetit hebraik për aq sa unë jam pashtun i Pakistanit si dhe politikane të Kosovës kanë mbajtur, zhvilluar dhe përparuar marrëdhëniet me persona të ngjashëm sikur këta të Izraelit. **Arrestimi i Gucait, komandant Calit dhe Nasim Haradinajt, ankth për shqiptarët dhe relaks për Serbinë dhe ndërkombëtarët:** Asnjëherë nuk u flasë fëmijëve për kohën e kaluar në llogoret e ish-Jugosllavisë ku kam qëndruar mbi 8 vjet, prej të cilave mbi 5 vjet isha në vetmi dhe izolim. I llogaris kohë të krenarisë dhe lavdisë, jo personale por se patëm guxim ta kundërshtojmë një shtet të fuqishëm si ish – Jugosllavia dhe që kontribuuam që ta heqim, së paku një gur nga themeli i kësaj ngrehinë të dhunshme dhe shtet që ua piu gjakun me pambuk shqiptarëve që e donin lirinë dhe bashkimin kombëtar. Këto përjetime i kujtojmë me disa shokë me të cilët kemi qenë në llogoret e ish-Jugosllavisë e që e kanë ruajtur të papërlyer idealizmin e dikurshëm. Kam menduar se lufta e fundit çlirimtare në Kosovë e udhëhequr nga e lavdishmja Ushtri Çlirimtare e Kosovës do të sendërtojë ëndrrat tona aq më parë që shumica e bashkëveprimtarëve të arrestuar u bënë bartës të pushtetit (thuaja fiktiv), në Kosovë, Maqedoni të Veriut apo Luginë të Preshevës dhe kemi besuar se, kur ta rreh pyka-pykën nuk do të bëjnë kompromis që e dëmtojnë shtyllën kurrizore të Kombit dhe shtetit aq më parë që tash, për mosbindje eventuale më së shumti që mund të ngajë është humbja e postit dhe karriges kurse, më parë e lënin peng edhe jetën dhe kokën duke mos pranuar kompromise të tilla. Pas përfundimit të luftës në disa raste jam ndërës shumë keq sikur kur ushtarët ndërkombëtarë i shtrinin përtokë ushtarët e UÇK-së që hynin në Prishtinë me uniforma të UÇK-së. Disa edhe janë vrarë nga ushtarët dhe policët ndërkombëtarë dhe asnjëherë nuk kanë dhënë

përgjegjësi. Mbytja me dhunë e fëmijëve shqiptarë në lumin Ibër në fshatin Çabër asnjëherë nuk më largohet nga mendja sikur që edhe mosgatishmëria e ndërkombëtarëve për të siguruar drejtësi për viktimat dhe përgjegjësi për kriminelët më përcjellë tërë kohën. Ekzekutimi kriminal i Mon Balajt dhe Arben Xheladinut nga kriminelët rumunë të veshur me uniformë të policisë së UNMIK-ut dhe sigurimi i imunitetit për mosndjekje penale për ata që e bënë krimin më përcjellë tërë kohën. Këtij krimi i patën fryrë edhe disa ambasadorë të akredituar në Kosovë sikur edhe disa media elektronike dhe të shkruara të Kosovës. Po pse ndodhi kështu? Në kohën kur Fatmir Sejdiu ishte president i Kosovës dhe kur Hashim Thaçi ishte kryeministër, në një takim me ndërkombëtarët iu bënë me dije se do të formohej një Gjykatë Speciale që do të gjykonte krimet e UÇK-së pas një raporti politik të Dik Martit. Këtë gjykatë duhet ta formonte Kuvendi i Kosovës, si pjesë e sistemit të drejtësisë kosovare ndërsa të gjitha të drejtat do të delegoheshin te ndërkombëtarët si ; hetuesia , policia , administrata , prokuroria dhe gjyqësori sikur që edhe selia e paraburgimit , burgut dhe gjykata do të vendosej në Hagë (Holandë). Të dyshuarit , të akuzuarit dhe të dënuarit do të ishin 100 për qind shqiptarë pasi tani serbët konsiderohen nga bashkësia ndërkombëtare si viktimat!!!!!! Udhëheqësit më të lartë të Kosovës e pranuan këtë por nuk e bënë publike për media . Nëse Kuvendi i Kosovës nuk do ta votonte këtë Gjykatë atëherë , si gogol e përdornin Këshillin i Sigurimit ku do të kishte rusë, kinezë dhe kundërshtarë të pavarësisë së Kosovës. Shikuar nga realiteti i sotëm, njëqind herë më objektiv dhe më i mirë për Kosovën ka qenë Tribunali i Hagës që ishte themeluar nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara se kjo Gjykata raciste që dhunshëm dhe në kushte të terrorit psikologjik u votua në Kuvendin e Kosovës. Tribunali i Hagës për ish – Jugosllavinë ka qenë më gjithëpërfshirës sepse ka bërë përpjekje të sigurojë drejtësi për të gjitha viktimat dhe përgjegjësi për të gjithë kriminelët , pa bërë dallime në baza etnike kurse Gjykata Speciale mbështetet ekskluzivisht në pariminin etnik. Të gjithëve iu kujtohet që ambasadori i një shteti shumë të fuqishëm publikisht deklaronte në media se Gjykata Speciale do të merret me 10-12 persona në ndërkohë që deri më tani , qoftë si dëshmitarë apo të dyshuar janë ftuar për intervistim së paku 300 individë. Është ftuar, kryesisht si e dyshuar e tërë udhëheqja politike dhe ushtarake e UÇK-së e që e përjashton parimin e keqpërdorur për përgjegjësi

individuale ! Vetëm Gjykata e Nurembergut ka ndjekur të gjitha strukturat politike dhe ushtarake të Gjermanisë, si shtet që e ka humbur luftën e dytë botërore dhe që ka shkaktuar dhjetëra milionë viktima, civile dhe ushtarake. Gjykata Speciale ndjekë strukturat politike dhe ushtarake të UÇK-së kurse amnistion strukturat politike , policore dhe ushtarake të Serbisë që kanë përgjegjësi për dhjetëra dhe qindramijëra viktima në hapësirat e ish-Jugosllavisë. Gjykata Speciale kërkon drejtësi për 5-6 % të viktimave kurse ua mohon drejtësinë 95 – 96 të viktimave . Ky proporcion është i njëjtë edhe për ata që kanë shkaktuar krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Në rrethana “misterioze” nga Gjykata Speciale rrodhën dosje për raste dhe dëshmitarë të mbrojtur dhe , me postë të shpejtë përfunduan para zyrave të OVL-së së UÇK-së . Pati bastisje bashkëpunimi të Policisë, dikush po thotë të Gjykatës Speciale e të tjerët se ishin policë të EULESH-it e që pastaj arrestuan Hysni Gucatin dhe Nasim Haradinajn e që paraprakisht e kishin arrestuar Sali Mustafën-komandant Calin. Duhet të theksohet se Dhomat e Specializuara si dhe Prokuroria e Specializuar kundër UÇK-së e mbase edhe policia ishin nga mbetjet mortore të Tribunalit të Hagës, UNMIK-ut dhe EULESH-it. Gjithashtu është e qartë se, së paku 95 për qind e të dyshuarve dhe të arrestuarve janë anëtarë të OVL të UÇK-së dhe kjo organizatë e ka detyrim moral dhe material të mbrojë anëtarësinë e saj. Askush nuk u hetua apo arrestua pse rrodhën dosjet nga Gjykata Raciste Speciale kurse u arrestuan veteranët e luftës që , në fund të fundit nuk mund të vepronin ndryshe. Është çështje tjetër nëse Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj do të ziheshin me pelë për dore duke marrë dosjet e ndjeshme nga Gjykata Speciale . Dëshmitarët e mbrojtur (sot nuk ka më dëshmitarë të mbrojtur) i ka rrezikuar Gjykata Speciale që ka lejuar të rrjedhin dosjet e ndjeshme dhe përgjegjësinë për humbje të jetëve të këtyre dëshmitarëve e ka pikërisht Gjykata Speciale. Nuk kam besuar se 22 vjet pas përfundimit të luftës, policë të pidentifikuar, me sjellje kusarësh do të arrestojnë qytetarë të Kosovës në kohën kur në vend janë mbi 10.000 policë të Kosovës. Kjo është e rëndë dhe turpëruese. Nëse dikush mendon se do të përfitojë nga kjo situatë duke e fituar mosndjekjen penale , ua kujtoj , për të satën herë fundin e Sllobodan Millosheviqit. Është poshtëruese të kalohet aq lehtë mbi arrestimin e Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt, duke amnistuar aktorët e vërtetë të aferës së rrjedhje së dosjeve duke kërkuar rrethana lehtësuese për të arrestuarit. Skajshmërisht e pamoralshme!

Të gjithë thonë se Kosova i ka përmbushur kriteret për liberalizim të vizave por se vizat nuk po liberalizohen. Po kushtëzohen me lëshime politike dhe kompromise “kreative”. Injorantët besuan se Grenell, gjatë vizitës së fundit në Kosovë do të sjellë heqje të vizave për qytetarët e Kosovës për ShBA. Doli të jetë rrenë që vet e lëshuam dhe vet besuam në te! Në fakt, pa asnjë procedurë për viza dhe pa aplikuar fare , të lidhur me pranga, me fluturim special udhëtuam Sali Mustafa-Komandant Cali, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, për fillim! Duket se numri i këtyre përfituesve nga lotaria e Dik Martit dhe Aleksandër Vuçiqit do të rritet në të ardhmen, për turpin e atyre që ndajnë padrejtësi, në emër të drejtësisë dhe për turpin tonë që nuk kemi guxim qytetar as të reagojmë, jo për të mbrojtur krimin por në kërkim të drejtësisë për të gjitha viktimat!

Për të gjithë ata që mendojnë se këtë herë Edi Rama e ka betejën me Bashën dhe Kryemadhin, do të kemi një dimër përvëlues dhe një pranverë dimri para vetes



Bedri ISLAMI

Të gjithë ata që mendojnë se Edi Rama këtë herë e ka betejën me Lulzim Bashën dhe Kryemadhin, janë të gënjyer. Edhe

ata që kanë pasur bindjen se Berisha do t'i përveshë mëngët dhe do të jetë më i pranishëm se kurrë në fushatë, përsëri janë të gabuar. Berisha vetë është në zdërrhalljet e tij politike, që nuk janë asgjë tjetër veçse ripërsëritje e një lajtmotivi të njohur, por që tani nuk ka as forcën, as mbështetjen dhe as të panjohurën e duhur në politikë. Edhe në listën e deputetëve të opozitës ai do të futet me forcë, përmes tri përbuzjeve dërmuese; të Lulzim Bashës - Berisha mund të kandidojë ku të dojë, që do të thotë është njëllë për ne; të ish ministrit të Ekonomisë Ruli, i cili i bëri thirrje haptas të largohet, sa nuk e kanë larguar, dhe në fund, Mustafaj lojal ndaj rolit institucional, që, duke e mbrojtur si të domosdoshëm, në fakt, në mendimin politik i dha shtysën. Berisha, këtë herë, do të jetë lojtari rezervë, do e ndjekë nga stoli dhe kur të futet në lojë, do të prishë punë.

Tjetër kush ka vendosur të jetë njeriu që ka marrë përsipër të përballojë Ramën dhe këtë, me gjithë postin e tij, shpesh herë honorifik, ai po shfaqet haptas, duke lënë në hije gjithë të tjerët. Në secilën ditë të vitit ai shpall kredon e tij për rrëzimin e qeverisë dhe këtë tashmë nuk e fsheh në asnjë çast, i gatshëm të marrë mbi vete gjithçka mbi rolin që i takon.

Treni i votuesve të opozitës mund të kenë vënë në fillesë portretin e Bashës, por në fakt makinisti është një tjetër. Ai quhet Ilir Meta dhe është de jure presidenti i Republikës, i zgjedhur, thuaj përdhunshëm në këtë post nga e majta, që sot është mëria e tij më e madhe, dhe, de fakto shefi real i opozitës në të gjitha përmasat e saj.

Të gjitha çfarë kanë ndodhur deri tani do të duken si lojëra fëmijësh ndaj asaj që ka vendosur të përballojë dhe, edhe nëse nuk do të ketë përsëri një miting alla 2 mars, ku sheshin e mbushën pasuesit e Bashës, që menduan se ajo ishte dita e fundit e parlamentit, por flamurin e mori presidenti, që, si asnjëherë tjetër, vendosi të ecë përmes dy rrugëve: ose të bëjë harakiri politik dhe e bëri, ose të trajtojë të gjithë këtë si betejë finale. Dhe ai e ka konceptuar si betejë e jetës së tij. Pas saj ai, ose do të jetë një askush, ose do të jetë njeriu që i ka mundur të gjithë: Nanon, mentorin e tij në vitin 2005, kur e rrëzoi nga pushteti që edhe ai vetë donte të binte, i lodhur sa më nuk ka; Ramën në zgjedhjet bashkiake, kur u vendos në krah të

Bashës, duke e ditur se ky nuk do të mund të ishte kurrë rivali i tij politik; dhe së fundi edhe Berishën në zgjedhjet e vitit 2013, kur papritmas u bë njësh me Ramën nxori shpatën nga milli, kërcënoi furishëm dhe kapi rishtas pushtetin.

Për shumë vite, më saktë deri në vitin 2017, ai ishte njeriu i tretë i domosdoshëm i qeverisjes, kandari i së cilës rëndonte nga shkonte vetë ai, ashtu i shëndoshë si ishte, peshë e rëndë dhe muskuloze në politikë.

Me humbjen e peshës, duket se humbi edhe fuqia e tij politike. Viti 2017 e gjeti atë në një gjendje nokdauni, kur do të ndodhte edhe rënia e parë e ndjeshme e forcës së tij. I vetëdijshëm se humbja do të sillte katastrofën, ai hoqi kostumin presidencial, të porsa qepur, rimori rrobat e njohura të LSI-së, nxori rishtas nga “tavanët e vjetër hutat e tij”, dhe si nuk kishte ndodhur vetëm në kohën e Berishës së parë, kërcënoi me luftë.

Mes Ramës dhe Metës ka një histori të vjetër dashuri - urrejtjeje, për të kaluar më pas në urrejtje - dashuri, duke shkaktuar tajfunë politikë kur kanë qenë së bashku, dhe batica- zbatica gazmore kur ua ka marrë mendja se bëjnë pa njëri tjetrin.

Të bashkuar për të mundur Nanon, herë pas here i janë kthyer përkëdheljes së tij, si ndaj një të keqeje të domosdoshme, që, edhe ashtu, si i përgjumur, mund të zgjonte dreqërit e vjetër të një lëvizjeje politike besnike ndaj shefit dhe të qetë të ditën e votimit. Duke mundur Nanon, që në fakt cinik siç është, e merrte të gjithë këtë agresivitet me sportivitet, e në të njëjtën kohë duke marrë me vete edhe haraçin e mundjes së tij, ata, të dy, e dinin se një ditë do të përballeshin ashpër. Shqipëria ishte e vogël për, dy njerëz që nuk e dinin të qenit jashtë politikës dhe ku ishin rastësisht bashkë, pas një fillese të kundërt. Rama po bëhej shefi i të majtëve, duke qenë fillimisht i gjithi i ekstremit të djathtë, “dashuri” që ende nuk e ka harruar; Meta po kalonte në prehrin e asaj që quhej e djathtë, kur pikërisht nga ajo do të ishte deputeti i parë të cilit i kërkohej heqja e imunitetit. Rama e llogarit me kujdes edhe sot e kësaj dite goditjen nën brez të Metës. Meta e ka parashikuar momentin dhe vendin ku mund ta godasë “i gjati”. Një histori e tillë, “me zemra të këputura” dhe “lidhje dashurie ngjalore”, që pak ose aspak ka të bëjë me dinjitetin, është në të shumtën e rasteve përlllogaritje pushteti dhe mbijetese.

Rama e di se humbja e tij do të thotë në një mënyrë ose një tjetër edhe fundi i jetës së tij politike drejtuese dhe roli i tij si shefi i madh brenda së majtës do të jetë drejt fundit. Ai e ka llogaritur këtë, por jo gjithnjë hesapet e shtëpisë të dalin në Pazar.

Meta e di, po ashtu, se një fitore e Ramës në mandatin e tretë, më shumë se sa humbje e Bashës, do të jetë humbja e tij.

Basha mund të humbasë dhe të largohet pa lënë gjurmën e tij në historinë e PD-së, por kjo nuk do të thotë se të gjitha meritë, mallkimet e shëmtitë do të bien mbi të. Ndoshta, duke u nisur nga kjo pasvijë, ai po e lë topin e politikës më së shumti në këmbët e Ilir Metës, duke e ditur se, në nëse fitohen zgjedhjet ai do të jetë shefi i qeverisë, dhe, nëse humbasin, ai nuk do të jetë i mallkuari i madh.

Mandati i tretë i Ramës është çmitizimi përfundimtar i LSI-së si pesha e mesit të artë. Ajo do të kthehet në një peshë pupël dhe këtë e di shefi i presidencës. Pas saj mund të ndodhin disa gjëra të frikshme për të, por të mirëpritura për njerëzit. Mund të nisë shkallmimi i politikës së vilave, që do të niste nga Lalzi, vendi i politikës mjerane, i drejtësisë mizerje dhe i korupsionit fatal, për të shkuar drejt një goditjeje që askush sot nuk e mendon.

Jo më kot, institucione të rëndësishme ndërkombëtare, më së shumti evropiane, po këmbëngulin që të nisë goditja e peshqve të mëdhenj, dhe gjithkush e di fare mirë se është vështirë të nisë shturja e pëlhurës, pastaj gjithçka rrjedh vetë. Dosjet e dërguara në SPAK, jo vetëm nga institucione vendore do të përbëjnë jo shumë larg gjithë barrën e këtij institucioni. Marrëveshja e fundit mes Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Institucioneve të Drejtësisë, për çka ka pasur këmbëngulje të hershme edhe nga ish kryetari i KLSH, Bujar Leskaj, është po ashtu një tabu që po shembet.

Në vëzhgimin e këtyre institucioneve është pikërisht ky dualitet, mes shefit të presidencës dhe shefit të qeverisë, më shumë se sa ndërmjet shumicës dhe opozitës jashtëparlamentare, se vetëm përmes këtij dualiteti mund të krijohen përplasje të ndjeshme, pasi gjërat që janë vënë në lojë janë të mëdha dhe të rrezikshme.

Si duket, më mirë se të tjerët, Ilir Meta nuk e ka besimin pikërisht tek Basha, si lider i opozitës dhe si njeri, pasi, po aq sa ka peshë të rëndë në këmbë politikën cinike dhe qesëndisëse të Ramës, po aq ka edhe politikën heshtëse të Bashës. Atij i rëndon mospërfillja e tashme e Ramës, por edhe e sëmbon heshtja e Bashës. Ndërsa të parin e njeh më mirë dhe e di se goditja mund t'i vijë në secilin çast ku nuk e ka pritur, për të dytin e papritura mund të jetë me pasoja më të mëdha, si listë e veçantë e opozitës, pa përfshirë në të listën e LSI-së, që ka fituar disa herë deputetë nga tepricat e trenit të opozitës, partive të vogla etj, por edhe drojën se mos, nën ndikimin evropian, dy forcat e mëdha politike bëjnë një koalicion të madh, të përkohshëm, katër vjeçar, ku ai do të mbetej në zallin e politikës.

Përplasjet kanë nisur më herët se zakonisht dhe llogaritjet po bëhen më të shpeshta.

Do të kemi një dimër përvëlues dhe një pranverë dimri para vetes.

Kosovës iu shtua edhe një doktor i shkencës së historisë



Qyteti me rrënjë të vjetra shqiptare, simboli i qëndresës në themelimin e studimeve në gjuhën shqipe shekujve, po pasurohet çdo ditë me studiues serioz nga disa lëmi. Këto ditë, drejtimi i historisë u pasurua me hulumtime të nxjerra nga Sedat Kryeziu i cili së fundit mori gradën akademike Doktor i Shkencave Historike. Komisionit ishte i përbërë nga: Prof. dr. Nebi Dervishi, Prof. dr. Zeqirja Rexhepi, Prof. dr. Fehari Ramadani, Prof. dr. Isak Sherifi, Prof. dr. Zeqirja Idrizi. Dr. Sedat Kryeziu në temën e tij trajtoj pikërisht tezën e hulumtimeve “Ridajla e nacionalizmit serb pas vdekjes së Titos dhe forcimi i politikës antishqiptare në Kosovë dhe Maqedoni në vitet 1981 – 1989”. Kjo temë komplekse e pa hulumtuar sa duhet nga shqiptarët trajton burimin e nacionalizmit serb. Sipas autorit ky nacionalizëm ka rrënjë të vjetra që nga shekulli i nëntëmbëdhjetë dhe vazhdon mbi bazën e urrejtjeve ndaj kombeve tjera. Ai nxjerr fakte nga dokumentet serbe që nga viti 1829 tek “Kanuni i Vasojeviq” duke vazhduar me “Srbi- svi svuda” – Serb – të gjithë e gjithkund, nga Vuk Kazaxhiq në vitin 1836 dhe duke vazhduar tutje tek “Naçertanje” e Ilija Garashaninit në vitin 1844, si

baza të platformës nacional shoviniste të ministrisë së punëve të jashtme të Serbisë për të ardhmen. Këto dokumente do jenë baza e programeve nacionaliste të pasuruar me “Iseljavanja Arnauta” - “Shpërngulja e Arnautëve”, të Vasa Çubriloviçit në vitin 1937, Ivo Andriçit në vitin 1939 do të del me “Elaborat o Albaniji” një program antinjerëzor shovinist mbi zhdukjen e shqiptarëve nga trojet e tyre. Aq më keq ky farë Ivo Andriç ishte laruar i Çmimit Nobel. Programe të tilla shoviniste vazhduan tuje me “Homogena Srbija” - Serbia homogjene, e vitit 1941, me autor Stefan Moljeviçin, pastaj “Memorandumi” i Akademisë së Shkencave të Serbisë në vitin 1986 i cili kishte synim dëbimin e shqiptarëve dhe jo serbëve tjerë dhe krijimin e Serbisë së Madhe. I gjithë ky shovinizëm u derdh mbi trevat shqiptare të pushtuara, veçanërisht pas rënies së Perandorisë Osmane në fillim të shekullit të kaluar. Studimi ndahet në disa kapituj duke filluar nga i pari me: “Premisat e rishfaqjes së nacionalizmit serb”. Këtu autori mundohet të shtjellon rrethanat pas Luftës së Dytë Botërore gjendjen dhe pozitën e popullsisë shqiptare, sistemin dhe zhvillimet politike, sidomos

ndryshimet politike të viteve 1966 e ato kushtetuese të viteve 1974, që si rezultat patën decentralizimin e Republikës Federative të Jugosllavisë dhe zgjerimin e autonomisë së krahinave. Forcat konservatore nacionaliste të njohura si rryma të drejtura nga Aleksander Rankoviç, ndryshimin e kushtetutës në drejtim të një decentralizimi më të madh të Jugosllavisë, e përjetuan si rrezikim të interesave serbe.

Periodha pas vdekjes së Josip Broz Titos në 1980 paraqet një moment kthese në historinë e popujve ku udhëheqja kolektive jugosllave që trashëgoi kompetencat e Titos nuk ishte në gjendje ta mbante gjendjen nën kontroll.


“Ngjarjet në muajt mars-prill 1981 dhe situata e krijuar pas tyre” e përbën kreun e dytë të disertacionit ku autori pretendon të ofrojë një vështrim të përgjithshëm rreth gjendjes në Kosovë e Maqedoni pas vdekjes së Titos, demonstratave të studentore në Kosovë, dhunën policore e ushtarake kundër shqiptarëve, diferencimin ideopolitik në institucionet universitare e shkencore. Duke atakuar Universitetin e Prishtinës që ata e konsideronin si çerdhen e nacionalizmit shqiptar, si dhe

tërë elitën akademike shqiptare, ata i hapnin rrugë synimeve për heqjen e Kushtetutës së vitit 1974 dhe krijimin e parakushteve për rivendosjen e centralizimit në RSFJ, që ishte një nga detyrat kryesore të nacionalizmit serb.

Kreu i tretë përfshinë: “Rishfaqja e nacionalizmit të heshtur serb 1981-1989” shtjellon ngjarje të rëndësishme që ndodhën pas pranverës shqiptare të vitit 1981. Të dirigjuar nga instanca të larta shkencore e religjioze, si nga Kisha Ortodokse Serbe, Lidhja e Shkrimtarëve të Serbisë, Akademia Serbe e Shkencave dhe Artave grupe të vogla përmes propagandës ishin në shërbim të nacionalizmit serb. Ata kishin parimin e moralit serb që përmes gënjeshtërisë së tyre të ndërtonin kauzë të rrejshme duke inskenuar incidente etnike dhe situata të paqena të cilat do të thellonin ndarjet etnike në Kosovë e do ta bindin opinionin publik jugosllav për pozitën e tyre të rëndë në Kosovë. Po ashtu, një trajtim i veçantë e shumëdimensional në këtë kapitull i jepet Memorandumit të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Artit të vitit 1986, që ishte çelësi programor i gjitha veprimeve shkatërrimtare të serbëve në Jugosllavi. Propozimet që u dhanë në

Memorandum kishin një ndikim të madh në formësimin e politikës millosheviçiane. Të gjitha hapat politikë dhe veprimet gjenocide që zbatoi Millosheviç në Kosovë. Në pjesën e fundit trajtohet tema “Përgatitja dhe zbatimi i planit për heqjen e autonomisë së vitit 1974 dhe revolta e shqiptarëve” rrethanat do fillojnë të ndryshojnë me te madhe me ardhjen e Slobodan Millosheviçit në kreun e udhëheqjes komuniste në Serbi. Ai do bëhet aktori kryesor i represionit ndaj shqiptarëve dhe të tjerëve dhe realizimit të programit të përgatitur nga qarqet nacionaliste serbe. Hiqet me dhunë autonomia e Kosovës në vitin 1989 dhe fillimi shembjes së Jugosllavisë. Millosheviç me meritë mori nofkën nga politika e tij e luftës ndaj kombeve tjera “Kasapi i Ballkani” i cili përfundon me shkatërrimin e shtetit. Autori ka shfrytëzuar burime të shumta arkivore, mediave dokumente të pa njohura. Shkencat shqiptare u pasuruan me hulumtime të reja nga autori i ri prej të cilit priten vepra të reja nga kjo fushë akoma pak e studiuar nga shqiptarët. Dr. Sedat Kryeziu i dëshirojmë shëndet e suksese në punën e tij shkencore.

Mr. sci. Hazir Mehmeti



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

FFK-ja kërkon rikthimin e tifozëve në stadione

PRISHTINË, 6 TETOR (ER) - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, në shoqëri të nënkryetarit Bakir Burri, sekretarit të përgjithshëm Eroll Salihu dhe drejtuesit të tifo-grupit të kombëtares "Dardanët", Lulzim Berisha janë takuar me ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj. Në këtë takim është biseduar për gjendjen aktuale të pandemisë Covid-19 në

vendin tonë dhe për rrjedhën e aktiviteteve të organizuara nga ana e FFK-së. Gjithashtu, është biseduar edhe për lehtësimin e masave kundër Covid-19, kurse presidenti Ademi e ka njoftuar ministrin Zemaj për vendimin e UEFA-s për rikthimin e tifozëve në stadione me 30 për qind të kapacitetit të stadioneve në ato vende ku një gjë të tillë e lejojnë autoritetet shtetërore. Me këtë



rast, presidenti Ademi ka kërkuar nga ministri Zemaj që të mundësohet që ndeshja e

radhës si vendëse në kuadër të Ligës së Kombeve kundër Sllovenisë të zhvillohet me

praninë e shikuesve, me numrin që është i lejuar nga UEFA, gjë e cila do t'u jepte motiv shtesë futbollistëve dardanë për lojë sa më të mirë, duke e ditur se tifozët kanë qenë shtytës të rezultateve pozitive për kombëtaren tonë. Ndërsa ministri Zemaj ka premtuar se do ta shqyrtojë me institucionet e tjera kërkesën e FFK-së dhe shumë shpejt do të merret vendim në lidhje me këtë çështje.

MKRS-ja investon 12 milionë euro në stadiumin "Adem Jashari" në Mitrovicë



MITROVICË, 6 TETOR (ER) - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka vizituar të martën Komunën e Mitrovicës, ku është pritur nga kryetari i kësaj komune, Agim Bahtiri. Gjatë këtij takimi është diskutuar për projektet kapitale në të cilat Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të investojë në këtë komunë. Dumoshi ka thënë se së bashku me kryetarin Agim Bahtiri kanë biseduar për projektet kapitale të cilat janë investime të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Stadiumi "Adem Jashari", i cili ka një kosto rreth 12 milionë e gjysmë euro, është projekt kapital, i cili pritet të përfundojë deri në fund të vitit të ardhshëm. "Në Komunën e Mitrovicës ia vlen të investohet sepse një është stadium i kategorisë së katërt, i cili i plotëson të gjitha kriteret e UEFA-s dhe do të jetë një ndër stadiumet më të bukura për shkak të kapaciteteve që ka. Ky stadium brenda do t'i ketë edhe shtigjet e atletikës dhe jashtë do të pasurohet edhe me një

teatër veror. Gjithashtu, ne do të investojmë edhe në projekte të tjera kapitale siç janë: Stadiumi 'Riza Lushta' në të cilin do të investojmë për tribuna si dhe tetë projekte për restaurim, duke filluar nga kulla e Isa Boletinit, shtëpia e familjes së Xhafer Devës dhe shumë projekte të tjera të rëndësishme", ka thënë ajo. Ndërsa kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka bërë me dije se deri më tani kanë realizuar 36 projekte të cilat i ka mbështetur Ministria e Kulturës.

Lazio i jep leje Muriqit të udhëtojë për ndeshjet e Kosovës, duke filluar me atë ndaj Maqedonisë së Veriut

Klubi i Lazios e ka publikuar listën e futbollistëve të cilët janë të angazhuar me skuadrat e tyre përfaqësuese. Nga 11 lojtarët që janë ftuar nga ekipet e tyre shtetërore, gjendet edhe emri i Vedat Muriqit, sulmuesit të Kosovës, i cili ka qenë i infektuar me Covid-19 dhe e ka tejkaluar sëmundjen. Në detajet e programit të publikuar nga faqja zyrtare e "Biancocelestëve" është thënë

se 26-vjeçari do të jetë në ndeshjen e së enjtes (8 tetor) ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës që zhvillohet në Arena "Todor Proeski" në Shkup. Këto dy përfaqësuese zhvillojnë përballjen gjysmëfinale të "play-off"-it në kuadër të Ligës së Kombeve, në kërkim të një shansi për të luajtur në Kampionatin Evropian. Skuadra fituese do të zhvillojë edhe një finale të "play-

off" kundër fituesit të përballjes tjetër që zhvillohet ndërmjet Gjeorgjisë dhe Bjellorusisë. Po ashtu, ai është liruar edhe për ndeshjen e Ligës së Kombeve kundër Sllovenisë që zhvillohet më 11 tetor (e diel) në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë si dhe në përballjen tjetër të Kosovës në kuadër të kësaj lige, kundër Greqisë më 14 tetor (e mërkurë) në "Spyros Louis Olympic Stadium" në Athinë.



Ish-ylli i Shqipërisë, Duro, emërtohet trajner i Feronikelit

DRENAS, 6 TETOR (ER) - Feronikeli ka njoftuar se e ka emëruar Klodian Duron, ish-yllin e Kombëtares së Shqipërisë, në postin e trajnerit të ekipit të parë. Duro ka nënshkruar marrëveshje dyvjeçare me klubin e Superligës së Kosovës. 42-vjeçari

nga Tirana do ta pasojë Afrim Tovërlanin, i cili u largua nga Nikli këtë fillimjavë për shkak të rezultateve të dobëta. Feronikeli i ka mbledhur vetëm pesë pikë në pesë javët e para në sezonin e ri në Superligë nën udhëheqjen e Tovërlanit.

Duro, ish-trajner i Kukësit, Kamzës dhe Luftëtarit, vjen për ta përmbushur synimin e klubit nga Drenasi për të fituar trofe. Profesionin e trajnerit e ka filluar menjëherë pas pensionimit nga futbolli aktiv, duke marrë drejtimin e Kukësit, klub me të cilin

arriti ta fitonte Kupën e Shqipërisë në sezonin e tij të parë. Ai i kishte regjistruar gjithsej 78 ndeshje për kombëtaren kuqezi, duke realizuar gjashtë gola. Duro do ta mbledhë skuadrën të mërkurën për stërvitjen e parë si trajner i Niklit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të nenit 66 dhe 67 të Ligjit nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregullores nr. 01/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të punës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rregullores nr. 03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

- 1. KOZ- 38/2020 Zvrtar i Lartë i Listës Votuese**
Grada/Koeficienti: Niveli Profesional- G6 -13.5
Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë: Udhëheqësi i Divizionit të Shërbimit Votues
Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat, pas periudhës provuese 1(një) vjeçare
Vendi: Prishtinë
Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:
1.Ndihmon në krijimin dhe mirëmbajtjen e listës së votuesve;
2.Mbështet vënien në zbatim të të gjitha operacioneve të shërbimit të votuesve në terren;
3.Ofron ndihmë profesionale për krijuesit e bazës së të dhënave;
4.Implementon Operacionet e Votimit përmes Postës dhe Votimin e personave me nevojë të veçantë;
5.Së bashku me Udhëheqësin e Divizionit të Shërbimit të Votuesve, mbikëqyrë shtypjen e listës përfundimtare të votuesve dhe listës komunale të votuesve;
6.Ndihmon në hartimin dhe menaxhimin e projekteve që lidhen me shërbimin e votuesve;
7.Detyra dhe përgjegjësi të tjera kur i caktohen nga mbikëqyrësi.
Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:
1.Të ketë Diplomë Universitare në Drejtësi, Shkenca Politike, Administratë Publike, Inxhinieri kompjuterike dhe Statistika;
2.Së paku katër (4) vite përvojë pune.
3.Integritet të lartë personal dhe profesional;
4.Shkathtësi të shkëlqyera në komunikim me gojë dhe me shkrim në gjuhët zyrtare;
5.Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në mënyrë të paanshme dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike;
6.Njohja e gjuhës tjetër zyrtare e dëshirueshme;
7.Njohje e gjuhës angleze e dëshirueshme;
8.Njohje të teknologjisë informative (MS Word, MS Excel dhe MS Access).

- 2.KOZ- 39/2020 Zvrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Zvečan**
Grada/Koeficienti: Niveli Profesional- G6 -13.5
Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë: Drejtori i Departamentit të Koordinimit në Teren
Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat, pas periudhës provuese 1(një) vjeçare
Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:
1.Kryeson Komisionin Komunal Zgjedhor në bashkëpunim të plotë me Sekretariatit e KQZ –së;
2.Përkujdeset për zbatimin e aktiviteteve dhe të gjitha akteve normative të nxjerra nga KQZ dhe Sekretariati në komunën përkatëse;
3.Mbikëqyrë dhe u cakton detyra anëtarëve të tjerë të KKZ –së;
4. Mbikëqyrë punën e trupave zgjedhore në komunën përkatëse;
5. Bën raporte për aktivitetet në periudhën zgjedhore dhe jo zgjedhore;
6. Koordinon aktivitetet në mes KKZ-së dhe Administratës Komunale dhe SKQZ-së;
7. Procedon në SKQZ kërkesat e Kuvendit Komunal për zëvendësimet e këshilltarëve komunal;
8. Ndihmon dhe këshillon subjektet politike dhe organizatat joqeveritare për zgjedhje;
9. Kryen detyra të tjera kur i caktohen nga mbikëqyrësi.
Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:
1.Të ketë diplomë universiteti në lëmin e drejtësisë, ekonomisë, administratës publike, shkencave politike, të drejtave të njeriut, administrim të zgjedhjeve, shkenca sociale, marrëdhënie ndërkombëtare, menaxhment ose në statistikë;
2.Së paku katër (4) vite përvojë pune;
3.Integritet të lartë personal dhe profesional;
4.Shkathtësi të shkëlqyera në komunikim me gojë dhe me shkrim në njërën nga gjuhët zyrtare;
5.Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në mënyrë të paanshme dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike;
6.Njohja e gjuhës tjetër zyrtare konsiderohet si përparësi;
7.Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme;
8.Njohje të teknologjisë informative (MS Word, MS Excel dhe MS Access);

